



Слушнете го нашиот глас

Проект финансиран од Европската Унија

RAPORT HOLISTIK PËR PERSONAT ME PENGESA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË



Shkupi, 2015

Publikimi:

Raport holistik për personat me pengesa në Republikën e Maqedonisë

Redaktorë të raportit holistik:

Dr. Zhaneta Poposka
Zvonko Shavreski
Elena Koçoska

Autorë të raportit për monitorim për përvoja personale:

Daniela Stojanovska – Xhingovska
Biljana Manevska
Ifraim Luta

Autor i raportit për media monitorim:

Darko Çekеровски

Autorë të raportit për monitorim sistemik:

Dr. Zhaneta Poposka
Zvonko Shavreski
Elena Koçoska

Drejtoreshë e Hulumtimit holistik për gjendjen e personave me pengesë në Republikën e Maqedonisë:

Vesna Jovanova

Drejtor i projektit:

Vladimir Llazovski



Овој извештај е изработен со помош на Европската Унија.

Содржината на публикацијата е одговорност единствено на авторот и на Отворете ги прозорците и на никаков начин не може да се смета дека ги одразува гледиштата на Европската Унија.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
HYRJE	4
I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME ME APLIKIM HORIZONTAL	6
I.1. Definicioni i pengesës (aftësisë së kufizuar)	6
I.2. Barazi dhe mosdiskriminim.....	7
I.2.1. Përshtatje e arsyeshme	9
II. AKSESUESHMËRI	11
II.1. Mjedis fizik	11
II.2. Transport.....	13
II.3. Informacione dhe komunikime.....	14
III. ARSIM	18
IV. SHËNDET	24
V. PUNË DHE PUNËSIM	29
VI. STANDARDI PËRKATËS JETËSOR DHE MBROJTJA SOCIALE	34
VI.1. Mbrojtja sociale.....	34
VI.2. Strehim	37
VI.2.1. Deinstitutionalizimi.....	38
VI.3. Standardi përkatës jetësor	39
VII. APLIKIMI KOMBËTAR DHE MONTIORIMI	42
BIBLIOGRAFI	44

PARATHËNIE

Të nderuar lexues,

Para jush gjendet raport holistik për gjendjen e të drejtave njerëzore të personave me pengesa në Republikën e Maqedonisë. Raporti i transmeton gjetjet dhe rekomandimet kyçe nga tre hulumtimet e zbatuara: Monitorim të përvojave personale të personave me pengesa, Ligjet dhe politikat në Republikën e Maqedonisë në fushën e pengesave (aftësive të kufizuara) dhe Njoftimin e mediave për personat me pengesa në Republikën e Maqedonisë.

Me nënshkrimin e Konventës për të drejtat e personave me pengesë në vitin 2007 dhe ratifikimin e saj në vitin 2011, dispozitat e saj u bënë pjesë e legjislacionit kombëtar dhe të njëjtat janë direkt të zbatueshme. Kjo i përfshin edhe anëtarët që merren me çështjen e mbrojtjes nga diskriminimi mbi bazë të pengesës, aksesueshmërisë, arsimit, punësimit, shëndetit, standardit përkatës jetësor dhe mbrojtjes sociale, që janë objekt i këtij raporti holistik.

Konventa thotë se shoqëria qytetare, veçanërisht personat me pengesa dhe organizatat e tyre, duhet të përfshihen edhe të marrin pjesë në tërësi në procesin e ndjekjes së saj. Duke u nisur nga ky fakt, si edhe duke e ndjekur parimin “Asgjë për ne, pa ju”, personat me pengesa hulumtonin, intervistonin dhe janë autorë të tre raporteve të detajuara, që janë të sublimuara në këtë raport holistik

Dëshirojmë të falenderojmë të gjithë individët, ekipet, organizatat dhe institucionet që ishin të përfshira në përgatitjen e raporteve individuale dhe të raportit holistik, që dhanë kontribut të pamasë për përgatitjen e tyre. Në fund, dëshirojmë të falenderojmë Delegacionin e Bashkimit Europian për mbështetjen financiare që e mundësoi përgatitjen e këtij raporti, dhe në të njëjtën kohë edhe ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë qytetare dhe të vetë personave me pengesa për përfshirjen e tyre aktive në procesin e monitorimit të të drejtave njerëzore të personave me pengesa (aftësi zë kufizuara).

Vladimir Llazovski
Drejtor ekzekutiv
Hapni Dritaret

Goran Llonçar
Kryetar
Qendra për orientim në shoqëri,
R. e Serbisë

HYRJE

Raporti holistik në lidhje me të drejtat e njeriut për personat me pengesa në Republikën e Maqedonisë u zbatua në kuadër të projektit “E dëgjoni zërin tonë”, të financuar nga Bashkimi Europian, Zbatues në Republikën e Maqedonisë është Hapni Dritaret në partneritet me Qendrën për orientim në bashkësi nga Beogradi. E njëjta është pjesë nga iniciativa globale e DRPI - Promovimi Ndërkombëtar për të drejtat e njerëzve me pengesë.

Gjatë përgatitjes së raportit, është ndjekur metodologjia e promovimit Ndërkombëtar e të drejtave për personat me pengesa me të dhënat e mëposhtme për çdo nga tre raportet. Pra, Raporti për monitorim të përvojave personale përfshiu shembull prej 105 intervista të thella të zbatuara në territorin e Republikës së Maqedonisë në rajonin verioro - lindor (Shkup, Kumanovë, dhe Kriva Pallankë), rajonin qendror - lindor (Veles, Shtip, Kavadarci, Strumicë, Gjevgjeli dhe vende të tjera të banuara), dhe rajonin perëndimor (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Ohër dhe Strugë). Në të treja rajonet janë zbatuar nga 35 intervista dhe u mbajt llogari për përfaqësimin e barabartë ndërmjet gjinive, sipas bazës etnike dhe sipas llojit dhe nivelit të pengesës. Ishin përfshirë persona me pengesa fizike / mobilitet, persona me dëmtim të pjesshëm ose të plotë të shikimit dhe persona me dëmtim të pjesshëm ose të plotë të dëgjimit.

Monitorimi sistemik është kryer në legjislativën aktuale dhe propozim - modifikimet e legjislativës në fuqi deri në fundin e vitit 2014, si edhe në strategjitë kombëtare dhe dokumentave programike të Qeverisë në shtatë fusha dhe ato: dispozita të përgjithshme me aplikim horizontal (duke e pranuar definimin për pengesë, barazi dhe mosdiskriminim, dhe përshtatje të arsyeshme), aksesueshmëri (me fokus të veçantë ndaj mjedisit fizik, transportit, informacionet dhe komunikimet), arsimit, shëndeti, puna dhe punësimi, standardi përkatës i jetesës dhe mbrojtja sociale (mbrojtja sociale, strehimi, deinstitutionalizimi, dhe standardi i përshtatshëm i jetesës), dhe në fund, aplikim kombëtar dhe monitorim.

Monitorimi i njoftimit të mediave në Maqedoni është zbatuar mbi bazë të klipit në 718 tekste dhe bashkëngjitje të zbatuara në periudhën nga korriku 2014 deri në janar 2015. Për nevojat e këtij raporti, janë analizuar pesë gazeta udhëheqëse kombëtare, Dnevnik, Veçer, Utrinski vesnik, Vest, Nova Makedonija, tre javë, Tea Moderna, Fokus dhe Kapital dhe disa revista mujore. Janë analizuar edhe bashkëngjitjet e gjashtë kaneleve më relevante televizive, Sitell, Kanal 5, Alfa, Telma, MRTV, 24 Vesti, një radio kombëtare - Makedonsko Radio (Radio Maqedonase) dhe më shumë televizione dhe radio stacione rajonale dhe lokale. Janë monitoruar edhe mbi 20 media online.

Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar Konventën për të drejtat e personave me pengesa (më tej në tekst: KDPP ose Konventa) në 30 mars të vitit 2007 dhe të njëjtën e ratifikon në 5 dhjetor të vitit 2011. Në mënyrë plotësuese, shteti e nënshkroi protokollin Fakultativ ndaj KDPP në 29 korrik të vitit 2009 dhe e ratifikon në 5 dhjetor të vitit 2011.¹ Instrumentat për ratifikim janë të deponuara në Organizatën e kombeve të bashkuara në 29 dhjetor të vitit 2011.

Në pajtueshmëri me nenin 118 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë², konventat ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e legjislativës kombëtare dhe nuk mund të jenë të ndryshuara me ligj. Me fjalë të tjera, dispozitat e Konventës janë direkt të zbatueshme dhe nga ana e gjykatave kombëtare që me kalimin e kohës do të mundësojnë krijim të praktikës konzistente gjyqësore si edhe zhvillim të instituteve juridike që e rregullojnë problematikën e mbrojtjes të së drejtës për personat me pengesë në të gjitha fushat e jetës shoqërore në bazë të

¹ Ligji për ratifikim të Konventës për të drejtat e personave me invaliditetet dhe protokollin fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e personave me invaliditet, G.Z. nr.172/11.

² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (dhe XXXII-të amendamentet), *Faqja e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë*, <<http://sobranie.mk/WBStorage/Files/UstavnaRmizmeni.pdf>> E qasur në: 19.10.2014.

barabartë me të tjerët. Ku, duhet patur parasysh qëllimi i Konventës si dokument i integruar, duke njohur se të drejtat në KDPP janë të pandashme dhe të ndërvarura.

Ky raport holistik përkrah analizës për të drejtat emërore në fushat e përmendura më sipër, merret edhe me çështjen e emërimit të mekanizmit nacional për mbikëqyrje në Republikën e Maqedonisë. Pra emërimi i institucioneve që do të kenë kapacitet, se si ta zbatojnë ashtu edhe ta mbikëqyrin zbatimin e dispozitave të Konventës, është *condition sine qua non* për vetë procesin e ratifikimit të saj.

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME ME APLIKIM HORIZONTAL

I.1. Definicioni i pengesës (aftësisë së kufizuar)

I: T'ju them të drejtën veçanërisht për zyrtarët që janë nëpër institucione të bëhet një trajnim, seminar që të rritet ndërgjegjësimi i tyre dhe ne të ndjehemi si të gjithë njerëzit.

Burrë, 58 vjet, person me shikim të dëmtuar

Definicioni i pengesës është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme sepse shumë shpesh përziehet mbrojtja sociale me krijimin e kushteve për përdorim të barabartë të të drejtave dhe lirive të personave me pengesë. Në Republikën e Maqedonisë, Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi³ nuk e definon pengesën dhe as që e definon grupin e mbrojtjes - persona me pengesë (aftësi të kufizuara). Atë e bëjnë edhe disa ligje të tjera, dhe ato: Ligji për mbrojtje sociale⁴, Ligji për punësim të personave invalidë⁵, Ligji për organizatat e invalidëve⁶, Ligji për mbrojtje të fëmijëve⁷ dhe për grupin e veçantë të personave të shurdhër dhe ata me vështirësi dëgjimi bëhet me Ligjin për përdorim të gjuhës së shenjave⁸. Pra, definimet ekzistuese (me përjashtim të asaj përmbajtjeje në Ligjin për Organizatat e invalidëve⁹) e pasqyrojnë modelin mjekësor të shikimit të pengesës dhe nuk u përgjigjen parimeve të dinjitetit dhe mosdiskriminimit dhe barazisë. Të njëjtit e definojnë grupin e mbrojtur ngushtë dhe i paraqesin personat me pengesë si të pazotë, pra japin në masë të madhe supozime për efektin e pengesës së tyre, në kundërshtim me KDPP

Larmia terminologjike kur flitet për persona me pengesa (me aftësi të kufizuara) shihet më qartësisht në njoftimet e mediave, që përdorin terma të numërta, që në numrin më të madh themelohen mbi modelin mjekësor.

Tekst numër 1, Slloboden Peçet, 16.12.2014

QË TË PAGUAJNË PËR MBETURINAT LANË PA PARA FAMILJE ME TRE INVALIDË

„Pa të ardhurën e vetme, pensionin nga jashtë shteti, ka mbetur familja katër-anëtarëshe nga fshati i Shkupit Milladinovci kur me urdhër të Ndërmarrjes publike komunale të Komunës Ilinden përmbartuesi u ka bllokuar llogarinë pa asnjë njoftim, dhe asnjë paralajmërim. Tre anëtarë të familjes janë Invalidë për të cilët kujdeset Vase Tasev. Ai është i revoltuar nga veprimi i tillë dhe nga pakujdesia e qeverive komunale“.

Rekomandime:

- Të qaset drejt ndryshimeve në legjisllacionin me qëllim definimin e personave me pengesë në pajtueshmëri me KDPP nga aspekti i modelit social.

³ Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, G.Z. nr. 50/10, 44/14, Vendim i Gj. Kusht.: 15.09.2010.

⁴ Ligji për mbrojtje sociale, G.Z. nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, [Teksti i konsoliduar: 148/13], 164/13, 187/13, 44/14, 116/14.

⁵ Ligji për punësim të personave invalidë, G.Z. nr. 44/00, 16/04, 62/05, [Teksti i konsoliduar: 87/05], 113/05, 29/07, 88/08, 161/08, 99/09, 136/11.

⁶ Ligji për organizatat e invalidëve, G.Z. nr. 89/08, 59/12, 23/13.

⁷ Ligji për mbrojtje të fëmijëve, G.Z. nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14.

⁸ Ligji për përdorim të gjuhës së shenjave, G.Z. nr. 105/09.

⁹ Në pajtueshmëri me nenin 5 nga Ligji për organizatat e invalidëve “[p]erson me invaliditet ... është individ që për shkak të lëndimeve të tij të lindura ose të fituara dhe pengesave (aftësive të kufizuara) të fituara ose të krijuara nga mjedisi i tyre fizik ose jetësor, që vetë nuk mund t'i plotësojë pjesërisht ose në tërësi nevojat jetësore personale, familjare dhe jetësore për jetë në mjedisin në të cilin jeton” (neni 5 paragrafi 2).

- Përfshirje në konceptet e diskriminimit për shkak të karakteristikës së supozuar dhe diskriminimit me asocim me person me pengesë në definicionin për pengesë.

I.2. Barazi dhe mosdiskriminim

M: A mund të na përshkruani ndonjë situatë konkrete ku keni qënë të diskriminuar në atë organizatë?

I: Domethënë nga e gjithë organizata vetëm për mua vonohej rroga, vetëm unë duhej të telefonoja në punë në orën 1 -2 pas mesnate, kryeja detyra që nuk janë në përshkrimin tim të detyrave të punës.

M: Çfarë mendoni pse ju ndodh kjo?

I: Ajo ndodh mbi të gjitha sepse këta punëdhënës e dijnë se njerëzit me nevoja të posaçme janë në gjendje të nënrenditur në krahasim me personat e tjerë në shoqëri.

Burrë, 34 vjet, pengesë trupore

I: Formova firmën time ku i shfrytëzova përfitimet që i ofron ligji për punësim të personave invalidë, por jo që të jem i punësuar, por që unë të vetë-punësohem. Pas rreth 7 - 8 vitesh nga funksionimi im, punësova një person me hendikep. Tani nuk lejoj punë që më kanë ndodhur mua, t'i ndodhin edhe personit, sepse e di diskriminimin... kur punëdhënësi nuk është person invalid ai ka më pak vetëdije dhe ndjenjë për nevojat dhe për mundësinë që një person të jetë i diskriminuar.

Burrë, 34 vjet, pengesë trupore

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, në nenin 9 të saj përmban klauzolë të përgjithshme për barazi që nuk e parashikon në mënyrë eksplicite pengesën si bazë diskriminuese, por në pajtueshmëri me nenin 8 nga Kushtetuta si edhe me ratifikimin e KDPP dhe me praktikë gjyqësore të gjykatës Europiane për të drejtat e Njeriut sipas parimit *pacta sunt servanda*, zbatohet edhe për personat me pengesë. Në mënyrë plotësuese, përkrah kritikave të numërta të nenit 9, shumë vjet Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar këtë klauzolë në mënyrë mjaft të kufizuar. Qytetarët në pajtueshmëri me nenin 110 paragrafin 3 nga Kushtetuta kanë të drejtë para Gjykatës Kushtetuese të dorëzojnë kërkesë për mbrojtje të së drejtave dhe liritë e njeriut që sillen në *inter alia* parandalim të diskriminimit.

Në mënyrë plotësuese, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, personat me pengesa (aftësi të kufizuara) i quan persona invalidë (neni 35 paragrafi 3), term që sipas pikëpamjes bashkëkohore të pengesës nga aspekti i modelit social është i vjetëruar dhe duhet të harrohet. Prandaj është e nevojshme që të kryhet ridefinim i dispozitave në Kushtetutë duke përfshirë ndryshim si terminologjik ashtu edhe thelbësor. Sepse, pas terminologjisë së caktuar pasqyrohet pikëpamja e shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj me personat me pengesë.

Legjislacioni kombëtar filloi në mënyrë të qartë që ta parandalojë diskriminimin në përgjithësi, duke përfshirë dhe mbi bazë të pengesës me marrjen e disa ligjeve, veçanërisht të rëndësishme janë ato në fushën e marrëdhënieve të punës¹⁰, dhe që kulminonte në vitin 2010 me marrjen e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji për marrëdhënie pune e parandalon në mënyrë të qartë diskriminimin në përgjithësi, duke përfshirë edhe ato mbi bazë të *invaliditetit* të kryera nga persona fizikë dhe juridikë si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat, pas saj duke e parandaluar diskriminimin direkt (neni 7 paragrafi 2), diskriminimin indirekt (neni 7 paragrafi 3) dhe shqetësimin (neni 9 dhe 9-a) të kandidatit për punësim dhe të punëtorit. Kritika është që Ligji nuk e parashikon instruksionin për diskriminim dhe nuk i parandalon në mënyrë të qartë as njoftimet diskriminuese dhe as deklaratat diskriminuese mbi bazë të pengesës.

¹⁰ Ligji për marrëdhënie pune, G.Z. nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, [Teksti i konsoliduar: 34/14]; Vendime të Gjykatës K. : 21.12.2005; 22.12.2005; 29.03.2006; 10.05.2006; 24.01.2007; 04.04.2007; 06.06.2007; 13.05.2009; 13.01.2010; 14.04.2010; 22.09.2010.

Nga ana tjetër edhe Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në nenin 3 të tij e përmend në mënyrë eksplicite *pengesën mendore dhe trupore* si bazë diskriminuese, duke e parashikuar edhe diskriminimin e shumëfishtë në nenin 12. Në të janë ndaluar në mënyrë të qartë të gjitha format e diskriminimit. Gjithashtu, ekziston nen i veçantë që sillet për diskriminimin e personave me pengesa në të cilin përmendet se “[n]ga diskriminimi i personave me pengesë mendore dhe trupore nënkuptohet pamundësim i qëllimshëm ose qasje e vështirësuar për mbrojtje shëndetësore, pra shkurtim të të drejtave të mbrojtjes shëndetësore, trajtim të rregullt mjekësor dhe medikamente, mjete rehabilitimi dhe masa në pajtueshmëri me nevojat e tyre, shkurtim të së drejtës për martesë dhe krijim të familjes dhe të drejta të tjera nga fusha e martesës dhe marrëdhënieve familjare, shkurtim të së drejtës për arsim, për punë dhe të drejtat e marrëdhënies së punës”. Kjo dispozitë edhe pse e mirë për shkak të theksimit të personave me pengesë si grup veçanërisht të prekshëm në shoqëri, megjithatë është i limituar në përfshirjen materiale të mbrojtjes për të drejtat ekonomiko - sociale.

Në drejtim të përmirësimit të statutit të personave me pengesa dhe integrimi i tyre në rrjedhat shoqërore, Qeveria e miratoi strategjinë e rishikuar Kombëtare për barazim të të drejtave të personave me invaliditet 2010-2018¹¹, si edhe strategjinë Kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim 2012 - 2015 së bashku me planin Operativ për mosdiskriminim mbi bazë të pengesës mendore dhe trupore 2012-2013¹². Megjithatë edhe përkrah legjislacionit ekzistues dhe politikave, hulumtimet tregojnë se diskriminimi mbi bazë të pengesës mendore dhe trupore është fenomen i shpërndarë gjerësisht në vend. Perceptimi për diskriminim mbi bazë të pengesës mendore dhe trupore është mjaft i lartë (42%). Këtë lloj diskriminimi më shpesh e venë re gratë (44%) se burrat (40%) dhe Shqiptarët etnikë (51%) se Maqedonasit etnikë (39%). Kur kësaj do t'i shtohet edhe fakti se gjithsej 41.2% e të anketuarëve nuk i dijnë të drejtat e tyre në rast se janë viktimë e diskriminimit, fitohet një situatë mjaft shqetësuese.¹³

Në pajtueshmëri me legjislacionin kombëtar ekzistojnë dy mekanizma kuazi-gjyqësore të cilave qytetarët mund t'ju drejtohen gjatë lëndimit të të drejtave të tyre për shkak të diskriminimit dhe ato: Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi dhe Avokati i popullit. Në periudhën 2011-2013, nga numri i përgjithshëm i ankesave të dorëzuara tek Avokati i popullit midis 0,99% dhe 1,35% sillen për diskriminim. Nga ana tjetër, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi në të njëjtën periudhë ka pranuar gjithsej 20 raste të diskriminimit mbi bazë të pengesës.¹⁴

Tekst numër 2, Vest, 02.07.2014

HETIM THEMELOR PËR TË GJITHË KOMPETENTËT PËR FËMIJËN SHURDHMEMEC

“Ministria për punë dhe politikë sociale inicjoi procedurë disiplinore dhe inicjativa për dënim të të gjithë personave profesionalë që në çdo mënyrë kanë qënë të përfshirë në rastin e fëmijës shurdhmemecë që ishte vendosur dhe ishte lidhur që të mos ikë, në Entin për mbrojtje dhe rehabilitim Banja BANSKO. Do të rishikohet edhe gjetja mjekësore, diagnoza për nivelin dhe llojin e pengesës së fëmijës, sepse ashtu siç dëshmoi komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, fëmijës i ishte shkruar se është i sëmurë nga paralizë e rëndë cerebrale, dhe kur u takuan me të, ai ishte fizikisht i shëndetshëm, vraponte dhe qeshte.”

¹¹ Strategjia kombëtare për barazim të të drejtave të personave me invaliditet, MTSP, Shkup, viti 2010, faq.15.

¹² Plan operativ për implementim të strategjisë Nacionale për barazi dhe mosdiskriminim mbi bazë të përkatësisë etnike, moshës, pengesës mendore dhe trupore dhe gjinisë 2012-2015, MTSP, Shkup, janar viti 2013, <<http://www.mtsp.gov.mk/?ItemID=BD66FCC3A7FBCB47AB9150CBFECD2C96>> E qasur në: 20.10.2014.

¹³ Shiko: Misha Popović, dhe Jasmina Mihailovska, *Barometëri i mundësive të barabarta*, Qendra Maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar, Shkup, viti 2013, faq.12-29, <<http://www.mcms.mk/mk/za-nasata-rabota/istrazuvana-i-publikacii/istrazuvana/1542-barometar-za-ednakvi-moznosti.html>> E qasur në: 20.10.2014.

¹⁴ Shiko: Zhaneta Poposka, Bekim Kadriu, Elena Grozdanova, Rexhepali Çuli, Elena Koçoska, *Analiza e praktikave diskriminuese në fushën e arsimit*, OBSE dhe MTSP, Shkup, viti 2014, faq.109-112.

I.2.1. Përshtatje e arsyeshme

Personave me pengesë u janë të nevojshme servise për mbështetje në vendin e punës, që nuk janë të siguruar në masë të mjaftueshme. Programet për përshtatje në vendin e punës nuk janë të disponueshme në vëllimin e nevojshëm.

I: Unë, si person i ri kam qënë e punësuar shumë herë. Kam kaluar përvojën e shumë punëve të këqija, do të thotë...ku nuk japin rrogë, ku nuk më rrjedh stazh... Isha e punësuar në shoqëri për mbrojtje, është e saktë ajo. Për fat të keq, ato shoqëri mbrojtëse punonin si shoqëri mbrojtëse, por ne nuk kishim kushte. Do të thotë, salla nuk është adekuate si për persona me invaliditet. Për shembull, kishte situata ku duhej të punosh në pllaka, hasesh me hapësira të rrëshqitshme. Do të thotë, nuk mund të lëvizësh lirisht/ Hasesh me probleme në vetë tualetin, që nuk përshtatet, si për mua. Do të thotë thjesht nuk mund të kryesh nevojën.

Grua, 38 vjet, pengesë trupore

I: Këtu në punë, organizata ime e punës më furnizoi me gjithçka, edhe laptop dhe lexues ekrani edhe telefon mobil me sistem operativ android që ka të inkorporuar lexues pa pagesë të ekranit që të mund ta përdor. Mbase sepse e tillë është organizata ose mbase sepse i tillë është pozicioni im, kujdesem që çdo pajisje ndihmë të ma sigurojnë dhe nuk kam pasur asnjë lloj problemi.

Grua, 28 vjet, person me shikim të dëmtuar

Edhe pse, përshtatja e arsyeshme është shumë e rëndësishme për personat me pengesa, megjithatë si institut juridik nuk është e përfshirë në mënyrë eksplicite në Ligjin për marrëdhënie pune, që vihet re si kritikë e madhe e këtij ligji. E njëjta tejkalohe në Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, ku definohet përshtatja e arsyeshme, dhe mos-sigurimi i saj konsiderohet si diskriminim në pajtueshmëri me nenin 8 paragrafi 2. Pra, Ligji parashikon se, “[p]ërshtatja e infrastrukturës dhe serviseve është

ndërmarrje e masave përkatëse të nevojshme në rast të caktuar që t’i mundësohet personit me pengesë mendore dhe trupore të ketë qasje, të marrë pjesë dhe të përparojë në procesin e punës, përveç nëse këto masa nuk imponojnë mbingarkesa disproporcionale për punëdhënësit”. Udhëheqësi për përshtatjen përkatëse¹⁵ nga viti 2014 drejton kritikë ndaj kësaj dispozite, sepse është kufizuese, pra silltet vetëm për përshtatjen e infrastrukturës dhe serviseve.

Krijimi i mundësive për punësim të personave me pengesa përfshin në mënyrë të pashmangshme dhe sigurim të përshtatjes së arsyeshme për këtë grup të personave në procesin e intervistës gjatë punësimit, si edhe në vendin e punës. Prandaj me nenin 7 paragrafi 2 nga Ligji për punësim të personave invalidë parashikohet përshtatja e arsyeshme për personat me pengesë duke përmendur se, “[g]jatë punësimit të personit invalid, punëdhënësi është i obliguar të krijojë kushte të përshtatshme për punësim dhe përshtatje në vendin e punës në varësi të vendit të punës, llojin dhe nivelin e arsimit dhe llojin dhe nivelin e invaliditetit të personit invalid që punësohet”. Ligjvënësi nuk e shpjegon në mënyrë më të detajuar këtë normë, pas saj duke përmendur se cilat janë ato kushte që duhet t’i krijojë punëdhënësi. Për shembull: a do të mund t’i përfshinin përshtatjet e procesit të intervistës gjatë punësimit, përshtatje në orarin e punës dhe praktikave të punës, dhe deri në sigurimin e trajnerit profesional.

Në mënyrë plotësuese, ligjvënësi nuk shpjegon në mënyrë më të detajuar asnjë lloj përshtatjeje të vendit të punës që duhet të kryhet, megjithatë ajo është e specifikuar me Rregullore për kritere dhe mënyrën e ndarjes së mjeteve të pakthyeshme nga fondi i veçantë për përmirësim të kushteve për punësim dhe punë të personave invalidë¹⁶. Pra, sipas nenit 7 paragrafi 2 nga kjo Rregullore përmendet se adaptimi përfshin përshtatje si në hapësirat e punës, në hapësirat

¹⁵ Shiko: Zhaneta Poposka, Zvonko Shavreski, dhe Natasha Amdiju, *Udhëheqës për përshtatje përkatëse*, OBSE dhe KZD, Shkup, viti 2014.

¹⁶ Rregullorja për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së mjeteve të pakthyeshme nga fondi i veçantë për përmirësim të kushteve për punësim dhe punë të personave invalidë, G.Z. nr. 156/2008.

ndihmëse ashtu edhe në pajisjet, mjetet për punë, aparatet dhe mjetet e tjera teknike për punë. Është mirë që përkrah obligimit për përshtatje të arsyeshme i njëjti ka parashikuar edhe mjete financiare që sigurohen nga fond i veçantë për përmirësim të kushteve për punësim dhe punë të personave me pengesë (neni 8 dhe neni 20). Megjithatë, shqetëson fakti që këto mjete që përmbahen në fondin e veçantë po zvogëlohen vazhdimisht. Pra, në periudhën nga viti 2000 - 2014 ky ligj është ndryshuar 8 herë, duke i zvogëluar mjetet në fondin e veçantë të mjeteve të përgjithshme të realizuara fillestare 15% deri 5% nga kontributi i përhershëm për punësim. Dhe si përfundim, ajo që ligjvënësi e parashikon në mënyrë të qartë është mundësia e kufizuar për përdorim të këtij instituti juridik. Pra, që një person të mund të kërkojë përshtatje të arsyeshme i njëjti duhet të jetë i punësuar në sektorin privat dhe t'i jetë i njohur ekzistimi i pengesës në pajtueshmëri me ligjin.

Rekomandime:

- Të qaset në ndryshimin terminologjik dhe thelbësor të dispozitave nga Kushtetuta që sillen për personat me pengesë duke e pasur parasysh modelin social.
- Ndryshim të dispozitës nga Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi që sillet për diskriminimin e personave me pengesë mendore dhe trupore duke e zgjeruar materialin e saj përfshirës të mbrojtjes të së drejtës ekonomiko - sociale.
- Të qaset deri në rregullimin e dispozitës nga Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi që sillet për përshtatjen e arsyeshme duke e zmadhuar përfshirjen personale të mbrojtjes, pra që një person të mund të kërkojë përshtatje të arsyeshme i njëjti nuk duhet të jetë i kushtëzuar që të jetë i punësuar në sektorin privat dhe t'i njihet ekzistimi i pengesës në pajtueshmëri me ligjin.
- Të ndryshohet dhe të jetë në pajtueshmëri Ligji për marrëdhënie pune me standardet ndërkombëtare nëpërmjet parashikimit të instruksionit për diskriminim, parandalim të qartë të njoftimeve diskriminuese, dhe përfshirje të dispozitës për përshtatje të arsyeshme.
- Të sigurohen mjete financiare për zbatim të strategjisë Kombëtare për barazim të të drejtave të personave me invaliditet 2010 - 2018 dhe strategjisë Kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim.

II. AKSESUESHMËRI

II.1. Mjedis fizik

Personat me pengesë në Republikën e Maqedonisë, hasen me barriera të ndryshme gjatë kryerjes së aktiviteteve të përditshme: hyrjen dhe përdorimin e objekteve të ndërtesave dhe objekteve publike, transportin publik, përdorimin e shërbimeve dhe prodhimeve.

I: Edhe platformat e pjerrëta janë të ndërtuara në mënyrë shumë të çuditshme sa ndonjëherë shkallët janë zgjedhje më e mirë. Ato janë shumë të pjerrëta, do të thotë që plotësisht shkallët për mua janë zgjedhje më e mirë sesa platforma e pjerrët sepse është gjeometri e çuditshme.

Grua, 32 vjet, pengesë trupore

I: Unë jetoj në një vend të vogël ku asnjë gjë nuk është e përshtatur për një person me invaliditet. Do të thotë, spitali është me shkallë, ndërtesa e sigurimit social është me shkallë, ndërtesa e policisë është me shkallë, banka është me shkallë, posta është me shkallë.

Grua, 45 vjet, pengesë trupore

I: Unë kisha edhe një vështirësi tjetër! Kur ishin votimet, zgjedhjet shtetërore, gjatë votimit, kisha vështirësi të votoj, sepse unë si person i verbër, person me shikim të dëmtuar, kam problem me qarkimin e fletës së votimit dhe me vete duhej të merrja shoqërues. Ajo ishte një vështirësi e madhe, dhe për mua mjaft e pakëndshme .. gjatë hyrjes në objekt ose në dhomën e votimit personin e mënjanuan, shoqëruesin tim, dhe më lanë vetëm në mes të dhomës dhe të gjithë si me telekomandë, unë sepse i verbër qendroj në mes të dhomës filluan të më drejtojnë majtas - djathtas, përpara - mbrapa, të lëvizësh kështu, si të isha ndonjë lloj instrumenti. Ajo është një vështirësi e madhe për një person të verbër.

Burrë, 48 vjet, person me dëmtim të plotë të shikimit

I: Për shembull, kur e di që duhet të shkoj në fondin për sigurim shëndetësor ose diku ku e di që ka një milionë shkallë deri atje. Ata kanë vendosur poshtë në dera një zile vetëm për invalidë - është e kotë sado që t'i biesh ziles, ata nuk zbresin poshtë.

Grua, 29 vjet, pengesë trupore

I: Bankomatet njëlloj, nuk janë të vendosur në lartësinë përkatëse, të gjithë janë lart dhe fillimisht ka shkallë dhe pastaj mund të arrish tek bankomati. Ndërtesa e policisë njëlloj - që të bësh kartë identiteti duhet të zbresësh poshtë nëpër shkallë ku nuk ka mbajtëse për dorën as nga ana e majtë dhe as nga ana e djathtë. Dhe shkallët janë të vjetra, të gjitha janë të dëmtuara, të pasheshta.

Grua, 45 vjet, pengesë trupore

I: Unë jam besimtare dhe ne me bashkëshortin shkojmë në kishë për festa. Por tju them edhe në kishë është e vështirë që të hysh. Ne si njerëz religjiozë duhet të kemi qasje... Të mos kesh as platformë të pjerrët për të hyrë...

Grua, 46 vjet, pengesë trupore

Në legjislacionin maqedonas, aksesueshmëria dhe disponueshmëria në mjedisin fizik është e rregulluar me më shumë ligje. Ligji për ndërtim¹⁷ e rregullon të drejtën për aksesueshmëri dhe disponueshmëri fizike tek objektet publike dhe sipërfaqet publike. Neni 13 paragrafi 1 tregon në atë që: “[n]dërtesë për destinime publike dhe afariste dhe ndërtesa me destinim për banim në ndërtesa banimi, si edhe ndërtesa me destinim banues - afarist duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar në atë mënyrë që personave me invaliditet do tu mundësohet qasje, lëvizje dhe qëndrim i papenguar dhe punë në ndërtesë”. Në mënyrë plotësuese me ndryshimet e reja të Ligjit për ndërtim¹⁸, neni 11 paragrafi 3 e rregullon çështjen për aksesueshmëri dhe disponueshmëri për sipërfaqet publike me projektimin dhe vendosjen e rrugëve për këmbësorë për lëvizje të personave me pengesë trupore dhe persona me shikim të dëmtuar. Në ligj është vendosur edhe afat kohor duke parashikuar se të gjitha objektet e ndërtuara me destinim publik dhe afarist duhet të jenë të disponueshme deri në vitin 2015 (neni 170). Në nivel lokal, planifikimi urbanistik dhe lëshimi i miratimeve për ndërtim është i rregulluar me nenin 22 paragrafi 1 nga Ligji për vetëqeverisje lokale¹⁹, në të cilin, për fat të keq, nuk janë parashikuar parimi i mosdiskriminimit dhe parimi i aksesueshmërisë. Në mënyrë plotësuese, në nivel lokal shfaqen probleme rreth kompetencave gjatë zbatimit të dispozitave të Ligjit për ndërtim, dhe interpretimi i ndryshëm me nenin 11 të Ligjit, të shpjeguar më lart²⁰.

Edhe përkrah legjislacionit ekzistues dhe politikave, hulumtimet tregojnë se megjithatë qytetarët me pengesë, ndjehen të kufizuar në mundësinë që të lëvizin nëpër rrugët e qytetit (61%), në qasjen tek dhe në objektet publike (52%), tualetet (65%) dhe shërbimet (74%)²¹. Aksesueshmëria e institucioneve është e përmendur si një nga pengesat në realizimin e të drejtave tek qytetarët me pengesë.

Kur bëhet fjalë për aksesueshmërinë, është e nevojshme që të përmendet edhe Rregullorja për mënyrën e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punën e personave me invaliditet tek dhe në objekte²², ku janë përcaktuar standardet minimale për mënyrën e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e personave me pengesë tek dhe në ndërtesat për destinim publik, afarist dhe destinim banues - afarist (neni 5 paragrafi 1). Në mënyrë plotësuese, me Rregulloren për standarde dhe normativa për planifikimin urbanistik²³ është e rregulluar e drejta për vendet e parkimit ku është parashikuar “3% e vendeve të përgjithshme të parkimit të jenë të siguruara për “invalidë” derisa në vendet e parkimit me më pak se 20 vende parashikohet minimumi një vend parkimi për invalidë. Vendi i parkimit për invalidë lokalizohet dhe shënohet në vendin më të afërt tek hyrja e ndërtesës dhe në sipërfaqen e këmbësorëve”.

Paralelisht në Rregulloren për kategorizimin e objekteve për kryerje të veprimtarisë së hotelierisë²⁴, si kriter për fitim të klasifikimit të objekteve të hotelierisë është: “[s]igurimi i dhomës për invalidë (obligim vetëm për objektet e reja që ndërtohen)”. Ky kriter sillet për të gjitha objektet nga 1 deri 5 yje.

Edhe pse, platforma ligjore dhe politikat e marra në këtë fushë janë mjaft të qarta, problemi shfaqet në zbatimin e tij përkatës në praktikë. Vetëm në mënyrë ilustruese, sipas gjetjeve të Avokatit të popullit në vitin 2013, në pjesën për aksesueshmëri në stacionet e policisë është konstatuar se “[n]ë pjesën më të madhe të stacioneve të vizituara të policisë nuk ekziston platformë e pjerrët qasëse për persona me nevoja të posaçme në hyrjen e stacioneve të policisë²⁵. Në mënyrë plotësuese, në vitin 2014 Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka proceduar dhe ka

¹⁷ Ligji për ndërtim, G.Z.nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13.

¹⁸ Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit për ndërtim, G.Z.nr 115/14.

¹⁹ Ligji për vetëqeverisje lokale, G.Z.nr 5/02.

²⁰ Shiko: *Hendikep – copëza e figurës që mungon, Raport për gjendjen e personave me hendikep*, Polio plus, viti 2012, faq.77, <www.polioplus.org.mk> E qasur në: 21.10.2014

²¹ Shiko: *Aksesueshmëri*, Polio plus, faq.68, <www.polioplus.org.mk> E qasur në: 21.10.2014

²² Rregullore për mënyrën e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e personave me invaliditet tek dhe në objekte, <http://www.mtc.gov.mk/new_site/images/storija_doc/115/pravilnici/25-2010.pdf> E qasur në: 21.10.2014.

²³ Rregullore për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik,

<http://mtc.gov.mk/new_site/images/storija_doc/1353/Pravilnik%20za%20standardi%20i%20normativi%20za%20urb.planiranje%5B1%5D.pdf> E qasur në: 21.10.2014.

²⁴ Rregullore për ndryshim të rregullores për kushte për kategorizim të objekteve për kryerje të veprimtarisë së hotelierisë, G.Z. nr. 62/04, 89/08, 115/10, 53/11.

²⁵ Raport vjetor i Avokatit të popullit 2013, faq.20.

vërtetuar diskriminim në pjesën e aksesueshmërisë mbi bazë të pengesës mendore dhe trupore²⁶. Në praktikë edhe pse ekziston obligim ligjor, shumica e subjekteve publike dhe afariste procedojnë në mënyrë individuale. Shembull ilustrues është rasti i Rrjetës për mosdiskriminimi²⁷ që në vitin 2013 ka dorëzuar ankesë tek të gjitha bankat për pasigurimin e qasjes së papenguar për personat me pengesë, me theks për personat me shikim të dëmtuar. Ndaj kësaj iniciative vetëm një bankë filloi iniciativë për ndërmarrje të masave për tejkalim të barrierave dhe ndryshim të dispozitave të brendshme, vetëm për personat me shikim të dëmtuar.

Tekst numër 3, Nova Makedonija 29.07.2014

PLATFORMA TË PJERRËTA QASËSE DHE ASHENSOR PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË POSAÇME

„Me projektin do të ndërtohen platforma të pjerrëta, ashensor dhe tualete speciale për nxënësit me nevoja të posaçme në gjithsej shtatë shkolla nga gjashtë komuna në rajon, dhe ajo është mundësi nëpërmjet fondeve europiane të mundësojmë inkluzion më të mirë të fëmijëve me nevoja të posaçme nga Kratova, Kumanova, Likova, Nagoriçanë e Vjetër, Rankovce dhe nga Kriva Pallanka.”

II.2. Transport

I: Me autoubas asnjëherë nuk kemi udhëtuar sepse nuk na është përshtatur. Ne gjithmonë udhëtojmë me makinë, me automobil.

Grua, 41 vjet, pengesë trupore

Ligji për transport në qarkullimin rrugor²⁸, nuk siguron barazi formale dhe thelbësore të qytetarëve me pengesë. Përballë asaj që siguron përfitime për transport të autorizuar. Domethënë “[t]ransportuesi dhe stacioni i autobusit janë të obliguar që personit me dëmtim të shikimit mbi 90% dhe shoqëruesit të tij me vërtetim për anëtarësim dhe karton udhëtimit të lëshuar nga Shoqata e personave të verbër dhe personit invalid me invaliditet trupor prej 100% dhe shoqëruesit të tij me vërtetim për anëtarësim dhe karton udhëtimit të lëshuar nga Shoqata e personave invalidë, tu japin biletë për udhëtim në të dyja drejtimet (biletë kthimi) pa kompensim dhe në librezën e udhëtimit të evidentojnë se personi i verbër dhe personi i invalid e kanë shfrytëzuar transportin” (neni 33 paragrafi 4) dhe ajo për maksimumin gjashtë bileta kthimi në transportin e brendshëm, në shpenzim të transportuesit” (neni 33 paragrafi 5).

Zgjidhje e ngjashme ligjore ka edhe në Ligjin për rrugët publike²⁹, ku është parashikuar përfitim për lirim të pagesës për kompensim për rrugët publike nga ana e personave me pengesë të definuara pas diagnozës si edhe përqindjes së pengesës 80% për dëmtim trupor dhe mbi 90% për persona të verbër të vërtetuar me akt nga komisioni kompetent në Fondin e sigurimit pensional dhe sigurimit invalidor të Maqedonisë. Në mënyrë plotësuese ligjvënësi i përcakton: dispozitat teknike për atë që duhet të drejtojë me automjetin, institucionet e autorizuar për lëshim të shenjës së veçantë, sigurim të dobisë nga lirimi i taksës së rrugëve për personat me pengesë të definuara pas diagnozës dhe përqindjes së pengesës, si edhe nevojën për posedim të librezave të anëtarësimit të lëshuara nga shoqëritë kompetente, të nënshkruara dhe të verifikuara nga ana e Ndërmarrjes publike.

Dispozita e vendosur e tillë i vendos personat me pengesë në pozicion të pavaforshëm dhe e kufizon të drejtën e shoqërimit, që çon drejt diskriminimit në vetë grupin e personave me pengesë. Nga ana tjetër, ligjvënësi në vend që të mundësojë që personat me pengesë ta gëzojnë të drejtën

²⁶ Raport i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, Kërkesë mbi bazë të qasjes së lirë të informacioneve viti 2014.

²⁷ Raport për rrjetën e mosdiskriminimit, viti 2013.

²⁸ Ligji për transport dhe qarkullim rrugor, G.Z. nr. 68/04, 127/06, 114/09, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11, Vendim të Gjyk.Kushtetuese: 01.02.2006; 14.05.2008; 10.11.2010.

²⁹ Ligji për rrugët publike, G.Z. nr. 84/08, 52/09, 114/09, 124/10, 23/11, 53/11, Vendim të Gjyk.Kushtetuese: 10.03.2010.

e transportit / lëvizshmërisë mbi parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë, jep përfitim financiar me të cilin përfshihen vetëm numër i caktuar personash me pengesë që përsëri duhet të jenë anëtarë të organizatave tradicionale të personave me pengesë. Në dispozitat e këtyre ligjeve, parimi për aksesueshmëri dhe disponueshmëri nuk janë të përmendura në kushtet për fitim të lejës dhe licencës së autobusëve, trenave dhe transportit të taksive, me qëllim plotësimin e të paktën minimumit të kushteve për sigurim të transportit të personave me pengesë.

Nga ana tjetër, mangësia gjatë rregullimit të vendeve të parkingut në Ligjin për siguri në qarkullim³⁰ është mos - definimi i asaj që vendi i parkimit për personat me pengesë, si edhe mos - definimi i përmbajtjes dhe pamjes së shenjës së veçantë që duhet të vendoset në automjetet për personat me pengesë. Paralelisht, ligjvënësi, nuk e ka rregulluar edhe çështjen për përdorim të automjeteve nga ana e asistentëve të tyre, si edhe prindërit e fëmijëve me pengesë. Kjo le hapësirë që pjesë e madhe e personave me pengesë të mos jenë të përfshirë me këtë zgjidhje. Në mënyrë plotësuese, neni 20 paragrafi 1 nga Ligji, thotë se “[p]ersonat e verbër, kur marrin pjesë në qarkullim në mënyrë të pavarur, duhet të mbajnë në mënyrë të detyrueshme bastun të bardhë - si shenjë për njohje”. Definimi i tillë i personave me shikim të dëmtuar është kufizues, duke pasur parasysh se personat me shikim të dëmtuar mund të përfshihen në qarkullim edhe me qen për udhëzues.

Mbi bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale³¹, dhe në lidhje me Ligjin për qytetin e Shkupit³² dhe Ligjin për mbrojtje sociale³³, Këshilli i Qytetit të Shkupit çdo vit sjell Program për përdorim të autorizuar të qarkullimit publik qytetar nga ana e personave me nevoja të veçanta³⁴, ku përsëri personat me pengesë janë të definuar mbi bazë të sëmundjes së tyre, diagnozën dhe përqindjen e pengesës dhe është vendosur kufiri i moshës deri 26 vjet.

Tekst numër 4, Dnevnik, 27.08.2014

PERSONAT E VERBËR JETOJNË SI NË ARREST SHTËPIE

“Që tu a lehtësojë lëvizjen e kësaj kategorie të qytetarëve, Ministria për punë do të ndërtojë dy rrugë speciale me lëvizje nga “Dare Xhambaz” deri në Sheshin Maqedonia dhe në parkun e qytetit.”

II.3. Informacione dhe komunikime

Qasja deri në informacione dhe komunikime i nënkupton të gjitha informacionet të karakterit publik që janë të destinuara për të gjithë qytetarët duke e përfshirë komunikimin e përditshëm me njerëz të tjerë. Të anketuarit tanë ndanë shumë përvoja në të cilat theksojnë se në moment të caktuar u është pamundësuar qasja ndaj informacionit të caktuar ose u është shkurtuar e drejta të arrijnë deri te informacionet.

I: Të gjitha komunat, spitalet, farmacitë, pothuajse të gjitha institucionet shtetërore në mënyrë të përgjithshme të gjitha institucionet duhet të kenë interpretues që të na kuptojnë se çfarë kërkojmë dhe dhe barazimin e atyre të drejtave me kategoritë e tjera të njerëzve.

Burrë, 46 vjet, person me dëgjim të dëmtuar

I: Shkoj në DAP, marr formular .. çfarë të bëj? I'u luta me edukatë personit zyrtar në sportel: “Do tju lutem, unë jam person i verbër dhe nëse dëshironi të më ndihmoni ta plotësojmë formularin”.

³⁰ Teksti i konsoliduar i Ligjit për siguri të Qarkullimit të Ministrisë së punëve të brendshme, <<http://www.mvr.gov.mk>> E qasur në: 23.10.2014.

³¹ Ligji për vetëqeverisje lokale, G.Z. nr. 5/02.

³² Ligji i qytetit të Shkupit, G.Z. nr. 55/04, 158/11.

³³ Ligji për mbrojtje sociale, G.Z. nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 96/13.

³⁴ Program i Qytetit të Shkupit për <http://ipserver.skopje.gov.mk/e-skopje/sluzben%20glasnik%20so%20konverzija.nsf/82aa49069edfbbb780256a22004ba9e0/e69ecd07e217b8a3c1257c2700484027?OpenDocument>> E qasur në: 21.10.2014.

Ajo fyese, më fyese nuk mund të ishte: “Nëse je i verbër, shko të gjesh shoqërues, nuk më intereson, çfarë do të bëhet nëse unë këtu ua plotësoj formularin të gjithëve?!”

Burrë, 46 vjet, person me shikim të dëmtuar

I: Letër në gjuhën braille në bankë askush nuk më ka ofruar, por kur duhet ndonjë kontratë unë personalisht ta plotësoj kërkoj asistencë nga ana e tyre, që ta plotësojnë njerëz nga ana e tyre. Deri tani kam hasur mirëkuptim.

Burrë, 46 vjet, person me shikim të dëmtuar

I: Në atë sistem bankar unë realisht nuk mund të shkoj dhe të disponoj vetëm me llogari transakcioni, me mjetet ata kërkonin shoqërues që do të jetë si dëshimtar, kështu që edhe këtu ne jemi të limituar.

Burrë, 32 vjet, person me shikim të dëmtuar

Të drejtën e aksesit në informacione dhe komunikime është e rregulluar me Kushtetutë (neni 16) dhe më shumë dispozita ligjore. Domethënë, me Ligjin për qasje të lirë në informacione nga karakteri publik³⁵, mbajtësit e informacionit për punën e tyre janë të obliguar që të mundësojnë informim për publikun. Megjithatë, kësaj dispozite i mungon konkretizimi që të mund të pritët realisht zbatimi i saj konsistent.

Me marrjen e Ligjit për përdorim të gjuhës së shenjave³⁶, gjuha e shenjave njihet si mënyrë e natyrshme e komunikimit të barazuar me komunikimin folës. Me këtë ligj, personave me dëgjim të dëmtuar u mundësohet e drejta e përdorimit të gjuhës së shenjave si palë ose pjesëmarrës në procedurat përpara organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale, organet gjyqësore, ndërmarrjet publike, institucionet, agjensitë, fondet dhe institucione e organizata të tjera (neni 4 paragrafi 1). Në mënyrë plotësuese, [p]ersoni i shurdhuar ose i verbër ka të drejtë të përdorimit të gjuhës së shenjave edhe në nevoja të tjera të jetës, me të shumtën deri 30 orë në vit, me realizim të së drejtës për interpretues. Nga ana tjetër zgjidhja për të drejtën e përdorimit të gjuhës së shenjave është e lënë në vendim të qendrës për punë sociale, që vetëm e kufizon në mënyrë plotësuese përdorimin e gjuhës së shenjave.

Edhe përkrah ekzistimit të dispozitës për mësim të gjuhës së shenjave nëpërmjet futjes së lëndës mësimore në Institutin për defektologji, në Shkollën për arsim fillor dhe të mesëm në të cilën obligohet fëmija shurdh ose i verbër, si edhe organizimi i trajnimeve për qytetarë nëpërmjet Shoqatës së shurdhëve, në praktikë ekziston numër i vogël i subjekteve publike dhe afariste që qasen ndaj mësimit dhe praktikimit të tij për përdorim të këtij shërbimi për qytetarët me dëgjim të dëmtuar. Ajo në mënyrë plotësuese e vërteton edhe lista e interpretesëve të gjuhës së shenjave në Republikën e Maqedonisë³⁷ në të cilën janë përmendur vetëm 12 persona, që tregojnë në mungesën e interpretesëve në shtet.

Ndryshe nga Ligji për përdorim të gjuhës së shenjave, në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston ligj i veçantë, dhe as pjesë e ligjit që do të mund ta stimulonte mësimin e gjuhës braille, që do të duhet të jetë e parashikuar në të ardhmen.

Në Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik³⁸, thuhet: “[n]ënshkrimi elektronik me çertifikatë të kualifikuar të dhënë në lidhje me të dhëna elektronike e rregullon çështjen e nënshkrimit elektronik që është i barazuar me nënshkrimin e dorës dhe vlefshmëri dhe fuqi të barabartë dëshmie, si nënshkrimi i dorës i dhënë në lidhje me dokumenta letre”. Kjo dispozitë edhe përkrah asaj që jep definim për nënshkrimin elektronik megjithatë nuk është e afuar me KDPP dhe përdorimin e faksimileve (vulave) si nënshkrim të personave me shikim të dëmtuar. Është e nevojshme që në ndryshimet e mëtejshme, të futet dispozitë për definimin e

³⁵ Ligji për qasje të lirë në informacionet e karakterit publik, G.Z. nr. 6/10.

³⁶ Ligji për përdorim të gjuhës së shenjave, G.Z. nr. 105/09.

³⁷ Shoqata kombëtare të personave të shurdhër të R. së Maqedonisë,

<http://www.deafmkd.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=55&Itemid=80> E qasur në: 20.10.2014.

³⁸ Ligji për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik, G.Z. nr. 34/01, 6/02, 98/08.

saktë të faksimilit (vulës), që si nënshkrim elektronik do të jetë i njohur nga ana e shtetit dhe do të trajtohet si nënshkrimi i dorës për personat me shikim të dëmtuar me vlefshmëri të përgjithshme.

Ligji për shërbime mediash audio dhe audiovizuale³⁹, nuk ka ndonjë dispozitë të rëndësishme që sillet për personat me pengesë. Ajo që shqetëson është se parandalimi i diskriminimit mbi bazë të pengesës nuk është e shprehur në mënyrë të theksuar në Ligj ku duke u sjellë për: aksesueshmërinë dhe disponueshmërinë e radiotransmetuesve, emitimin e informacioneve të qasshme dhe të disponueshme nga karakteri i ndryshëm. Kjo duhet të tejkalohet gjatë ndryshimit të ardhshëm të këtij ligji.

Strategjia nacionale për e-përfshirje (përfshirje elektronike)⁴⁰ përmban masa dhe aktivitete që mbështesin aspekte të përfshirjes sociale dhe të njëjtat janë të definuara nëpër 7 prioritete. Në kuadër të Strategjisë për e-përfshirje (përfshirje elektronike) 2011 - 2014 në R.M, pengesa është e pranishme në kontekstin e prioritetit 1. Domethënë, në vitin 2009 është krijuar portali i internetit për personat me pengesë (*sakamznammozam.gov.mk*) dhe për qasjen e tyre tek përmbajtjet elektronike. Por ky protal nuk është në funksion. Në mënyrë plotësuese, kjo strategji është përfshirë vitin 2014, dhe faqet elektronike shtetërore janë ende të padisponueshme.

Sipas mendimit të publikut se si informojnë mediat për personat me pengesë (në kuptim të paragjyqimeve ose papërshtatshmërisë me gjendjen reale) gjetjet tregojnë se personat me pengesë nuk janë shumë të interesuar për mediat, si edhe se mediat më shpesh e trajtojnë këtë problematikë nëpërmjet prezantimit të rasteve, dhe ajo më shpesh në mënyrë të papërshtatshme, ku qasja është senzacionale, plot me patetikë dhe keqardhje⁴¹.

Tekst numër 5, Tea Moderna, 19.11.2014

SI BEKIM NGA ZOTI

“Tregim frymëzues heroik për Toma Dimovski, piktor, muzikant, etnolog me paralizë cerebrale që ka atelje në Çarshinë e vjetër të Shkupit.”

Rekomandime:

- Ndryshim në ligjin për ndërtim me vendosje të teknikave konkrete dhe masave mbrojtëse për sigurim të qasjes të plotë dhe disponueshmërisë të objekteve. Në mënyrë plotësuese, është i nevojshëm formim i trupit të licencuar për qasje dhe disponueshmëri të objekteve.
- Ndryshim të rregullores ligjore që e rregullon çështjen e transportit, në drejtim të sigurimit të mjeteve të qasshme dhe të disponueshme të transportit, në nivel nacional dhe lokal. Në mënyrë plotësuese, janë të nevojshme ndryshime në drejtim të gëzimit të papenguar të së drejtës së lëvizshmërisë, si edhe të përfitimeve për transport preferencial, mbi bazë të pengesës.
- Rregullim shtesë të çështjes për vendet e parkimit si edhe mënyrat e përdorimit të përfitimeve për vend parkimi pa pagesë, me elemente teknike të definuara saktësisht.
- Ndryshim të Ligjit për media, Ligji për shërbime mediash audio dhe audiovizuale, në drejtim të futjes së klauzolës anti-diskriminuese. Në mënyrë plotësuese, futja e masave konkrete teknike për sigurim të qasjes së papenguar, disponueshmërisë së papenguar në informacionet për qytetarët me pengesë, si edhe sigurim të trajnimit të gazetarëve dhe drejtorëve të programit për këtë çështje.
- Ndryshim të Ligjit për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrim elektronik me përfshirje të faksimilit të jetë i njohur nga ana e shtetit si nënshkrim dore.

³⁹ Ligji për shërbime media audio dhe audiovizuale, G.Z. nr. 184/13, 13/14, 44/14.

⁴⁰ Strategjia Nacionale për e-përfshirje (përfshirje elektronike) 2011-2014, MIOA, Shkup, viti 2011, <http://www.mio.gov.mk/files/pdf/dokumenti/Strategjia_za_e-vklucuvanje.pdf> E qasur në: 21.10.2014.

⁴¹ Shiko: *Hendikep – copëza e figurës që mungon, Raport për gjendjen e personave me hendikep në R. e Maqedonisë*, Polio plus, viti 2012, faq.145.

- Ndryshim të Ligjit për qasje të lirë për informacione të karakterit publik me futje të dispozitave për mënyrat në të cilat çdo mbajtës i informacioneve do të jetë i obliguar të sigurojë informim të publikut në mënyrë të qasshme dhe të disponueshme për personat me pengesë.
- Futje të masave që do të mund ta promovonin mësimin e gjuhës së shenjave, si edhe ndërmarrje të masave për sigurim të numrit më të madh të interpretuesëve të gjuhës së shenjave. Në mënyrë plotësuese, është e nevojshme që të rregullohet çështja për përdorim të shkrimit Braille, si edhe përfshirje të dispozitave që do të mund ta stimulonin mësimin e shkrimit Braille.

III. ARSIM

Numri më i madh i të anketuarëve përmendën përvoja kryesisht në kuptim negativ, duke e theksuar arsimin si segment kyç në jetën e personave me pengesë që nga aspekte të ndryshme është i qasshëm / i disponueshëm në mënyrë të pamjaftueshme për këta persona. Mungesa e arsimit përkatës për personat me pengesë do të thotë fitim të barrierës së dyfishtë sepse, sipas automatizmit, pa arsim personat me pengesë mbeten jashtë nga mundësia për konkurrencë në tregun e punës. Megjithatë, duhet të theksohet se ekzistojnë edhe numër i caktuar përvojash pozitive me të cilat janë hasur disa nga të anketuarit.

I: Invaliditeti im lindi në fund të përfundimit të arsimit fillor... Tani kur më erdhi koha që të regjistrohem në vitin e parë gjimnaz isha i penguar nga arsyeja që gjimnazi im nuk ishte kaq afër dhe se unë nuk mund të arrij deri atje. Do të thotë këtu transport publik për persona invalidë nuk ka pasur, në qytet nuk më kujtohet nëse atëherë kishte edhe taksi që të paguash... për atë arsye isha i penguar që të shkollohem... ajo është arsyeja direkte. Nuk e kisha të mësuarën të diskutueshme dhe gjëre të tilla, por ishte e diskutueshme qasja deri në shkollë.

Burrë, 40 vjet, pengesë trupore

I: Po, çka sillet për maturën, ajo ishte ashtu një proces kaq shumë i paorganizuar në marrëdhënie me dhënien e provimeve të lëndëve eksterne sepse për lëndët eksterne vijnë profesorë nga shkolla të tjera, dhe për profesorët internë nuk kishte problem sepse këtu ishin njerëz që më njohin, për eksternët ishte problemi. Për maqedonisht dërguan një profesore nga shkolla për të verbër që është këtu, e cila ma lexonte testin, dhe për testin për gjuhën angleze doli problem shumë i madh sepse dëshironin të njëjtën

profesore të ma dërgojnë që nuk dinte anglisht,, do të thotë matura jepet në qershor, nëna ima që në tetor shkoi t'i përgatisë se do të ketë fëmijë që nuk sheh, që duhet ta japë provimin e maturës në arsimin e rregullt. Kishte propozim, sepse unë punoj në kompjuter me lexues, kishte propozim ta sjell laptopin dhe ata të ma transferojnë testin dhe unë ta zgjedh atë në kompjuter dhe të ketë njeri që do të qendrojë dhe do të më shohë se si e zgjedh testin dhe të më ruajë. Megjithatë ata atë nuk e pranuan. Një ditë para provimit kur nëna ima telefoni dhe tha - si llogarisni ta kryeni atë me profesore e cila nuk di anglisht, si do ta lexojë testin, ata thanë - epo mirë, nëse jo hajde le ta sjellë ajo kompjuterin, le ta shkruajë esenë e saj, sa ta kalojë maturën. Ajo ishte shumë përbuzëse për mua, sepse qëllimi im nuk është ta kaloj maturën, unë dëshiroj të tregoj dije.

Grua, 20 vjet, dëmtim të plotë të shikimit

M: Gjatë arsimit, ishit në shkollë të rregullt supozoj fillore, e mesme ashtu??

I: Po, shkoja në shkollë të rregullt por ajo nuk ishte falë asaj që sistemi i shte i mirë por sepse falë nënës time dhe babait tim, dhe unë vetë që duruam së pari të jem i pranuar në shkollë të rregullt që ishte proces dramatik bindjeje. Ishte fat që jetoja në vetë qendrën e qytetit që është qyteti kryesor dhe ku njerëzit kishin më shumë kapacitete të pranojnë njerëz me hendikep, dhe disi arrita sukses të hyj.

Burrë, 34 vjet, pengesë trupore

M: Dhe si ishit të pranuar nga profesorët, mësuesit?

I: Isha i pranuar mirë, zakonisht mund të them se sikur u vinte keq, ndonjëherë edhe me qëllim ishin më liberalë në lidhje me notat dhe me të tjerat.

M: A mendoni se ajo është në rregull?

I: Ajo nuk është në rregull, ajo sinqerisht më pengonte dhe tani më pengon sepse mendoj se edhe tani ndodh diçka e ngjashme... dhe mendoj se edhe ishte për shkak të pengesës time. Më shihte ashtu në mënyrë të çuditshme sikur më pyeste Çfarë kërkon ti këtu?

Burrë, 21 vjet, pengesë trupore

Kushtetuta e parashikon të drejtën e arsimit. Kjo e drejtë është me destinim të përgjithshëm dhe parashikon se çdokush [duke përfshirë edhe personat me pengesë] kanë të drejtë për arsim.

Në fushën e arsimit të personave me pengesë mendore dhe trupore ligje kyçe janë Ligji për arsimin fillor⁴², Ligji për arsimin e mesëm⁴³, Ligji për arsimin e lartë⁴⁴ dhe Ligji për arsim profesional dhe trajnim⁴⁵, i shpjeguar më poshtë. Ligji për arsim fillor parashikon klauzolë të përgjithshme anti-diskriminuese në të cilën, për fat të keq pengesa (aftësia e kufizuar) nuk është e përfshirë në mënyrë të qartë. Në mënyrë plotësuese, për nxënësit me pengesë (në ligj janë përmendur si: nxënës me nevoja të posaçme arsimore) sigurohen kushtet e përshtatshme për fitim të edukatës dhe arsimit fillor në shkollat fillore të rregullta dhe të veçanta dhe të njëjtët kanë të drejtë për ndihmë individuale për fitim të arsimit dhe edukatës fillore. Nëse ky nen lexohet në korelatë me nenin 10 paragrafi 3 që thotë se: “[a]rsimi fillor për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore organizohet dhe realizohet në shkolla fillore të veçanta dhe në klasa të veçanta pranë shkollave të rregullta fillore” do të arrijmë në përfundimin se inkluzioni i këtyre fëmijëve është vetëm deklarativ dhe se në thelbësi qëllimi i ligjvënësit nuk është arsimi i fëmijëve me pengesë së bashku me fëmijët e tjerë që nuk kanë pengesë në klasa të njëjta, por ndarjen e tyre më suptile. Se ku do të mësojë fëmija me nevoja të posaçme arsimore varet në masë të madhe nga zgjedhja e prindit, pra prindi ka të drejtë ta regjistrojë fëmijën e tij me nevoja të veçanta arsimore në sistemin e rregullt arsimor, “[p]ërveç në rastet kur nevojat e veçanta arsimore të fëmijës janë të tilla që do të duhet të ndjekë mësim në shkollë fillore të veçantë” (neni 51 paragrafi 1). Do të mund të përmendim se edhe në praktikë ky përjashtim duhet të jetë gjithmonë i individualizuar dhe nuk mund të përdoret për shkyçje të *a priori* të të gjithë personave me pengesë të caktuar nga i gjithë procesi arsimor ose nga një pjesë e procesit arsimor. Në mënyrë plotësuese, ligji parashikon se me plane dhe programe të posaçme arsimore organizohet dhe realizohet veprimtari edukativo - arsimore e nxënësve me nevoja të posaçme, të përshtatura në nevojat e tyre të posaçme arsimore (neni 30). Këtu duhet patur parasysh se këto plane dhe programe mësimore të përshtatura duhet të jenë me kualitet të barabartë si edhe me ato që përdoren për arsim të fëmijëve pa pengesë. Sipas treguesëve të Avokatit të popullit, është e nevojshme të sigurohen libra për mësim në shkollat e veçanta fillore dhe ato të mesme qo do tu përgjigjen nevojave të këtyre nxënësve dhe do t'i ndihmojnë ta zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.⁴⁶ Në mënyrë plotësuese, me nenin 42 paragrafin 9 nga Ligji për arsimin fillor përcaktohet mundësi në klasat në të cilat ka nxënës me nevoja të posaçme arsimore të angazhohet edhe person me studime të përfunduara për defektologji. Megjithatë. Derisa kjo është mundësi dhe jo obligim për shkollat i njëjti nuk do të jetë i respektuar në tërësi. Neni 61 paragrafi 2 nga Ligji për arsim fillor parashikon se, [n]xënësit me nevoja të posaçme arsimore kanë të drejtë për transport pa pagesë pa dallim të largësisë së vendit të tyre të banimit deri në shkollën fillore”.

Derisa arsimi fillor është të paktën inkluziv në mënyrë deklarative, arsimi i mesëm i personave me pengesë është shumë më ndarës. Domethënë, sipas Ligjit për arsim të mesëm, “[n]ë arsimin e mesëm për nxënës me nevoja të posaçme arsimore, arsimohen nxënës sipas programeve të përshtatura për profesione përkatëse pra profile arsimore ose për aftësim pune”. Kur do të marrim parasysh se programet për aftësim për punë janë të vjetëruara, dhe vendet e punës për të cilat aftësohen personat me pengesa më shpesh nuk korenspondojnë me nevojat e tregut të punës dhe bëhet pyetja për qëllimin dhe rezultatin e këtij arsimi dhe pas saj për mundësi reale për

⁴² Ligji për arsim fillor, G.Z nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14.

⁴³ Ligji për arsim të mesëm, G.Z nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/2004, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14.

⁴⁴ Ligji për arsim të lartë, G.Z nr.35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14.

⁴⁵ Ligji për arsim profesional dhe trajnim, G.Z nr.71/06, 117/08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 14/04.

⁴⁶ Informacion për gjendjen me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të posaçme në shkollat e veçanta fillore dhe ato të mesme, Avokati i popullit, Shkup, viti 2013, faq.19.

barazimin e shanseve të personave me pengesë në tregun e përgjithshëm të punës. Do të thotë, pa dallim të potencialeve të personave me pengesë në pajtueshmëri me kuadrin ligjor ata janë të parapërcaktuar për vende pune manuale të paguara shumë pak. Kjo dispozitë duhet të jetë e ridefinuar në drejtim të lejimit të personave me pengesë që arsimin e mesëm ta fitojnë në sistemin e rregullt arsimor, duhet të sigurohet që programet mësimore të jenë të drejtuara ndaj profesioneve më të sofistikuar dhe bashkëkohore që kërkojnë në tregun e përgjithshëm të punës. Problem plotësues shfaqet edhe për shkak të mos-aksesueshmërisë në institucionet arsimore për personat me pengesë, Duke pasur parasysh se arsimit fillor dhe ai i mesëm janë të detyrueshëm, dhe vetëm një numër i vogël i shkollave janë të arritshme, dhe bëhet pyetja për zbatueshmërinë e vërtetë të këtij obligimi ligjor.

Në ligjin për arsim të lartë parashikohet të gjithë shtetasit të kenë, të drejtë arsimit në institucionet e larta arsimore nën kushte të barabarta, (neni 7), derisa dispozita anti-diskriminuese vlen vetëm për procedurën e zgjedhjes së kandidatëve. Pra, në nenin 108 paragrafin 5 të Ligjit parashikohet se procedura për selektim të kandidatëve për regjistrim në institucionin e arsimit të lartë e garanton barazinë e të gjithë kandidatëve pa dallim të pengesës *inter alia* (më ligj qendron: invaliditet). Dy dispozitat e tjera të ligjit në të cilin përmenden personat me pengesë sillen në masat mbrojtëse me të cilat lehtësohet studimi i këtyre personave. Klauzola e përgjithshme anti-diskriminuese nuk ekziston. Çfarë sillen për aksesueshmërinë, sipas Ligjit për arsim të lartë (neni 150) të gjithë studentët mund ta shfrytëzojnë transportin, pajisjet, infrastrukturën shkencore dhe profesionale të institucioneve të larta arsimore, si edhe objektet universitare për veprimtari sportive dhe kulturore dhe shërbimet e standardit studentor e në mënyrë të ngjashme, nën kushte të barabarta. Megjithatë, nëse të njëjtat nuk janë të qasshme dhe të disponueshme atëherë kjo mundësi për studentët me pengesë është shumë e relativizuar. Gjithashtu problem i madh është edhe mos-aksesueshmëria në hapësirën dixhitale, pra sistemet e padisponueshme informative dhe komunikuese që në vend që të jenë vegël për përmirësim të inkluzivitetit të personave me pengesë në procesin arsimor, bëhen edhe një pengesë plotësuese.⁴⁷

Me ligjin për arsim dhe trajnim profesional rregullohen të drejtat dhe obligimet e institucioneve për arsim dhe trajnim profesional, si edhe punëdhënësit e përfshirë në trajnim praktik, në lidhje me organizimin dhe zbatimin e arsimit dhe trajnimit profesional në lloje, nivele dhe kohëzgjatje të ndryshme. Gjithashtu me këtë ligj rregullohen edhe të drejtat për lidhje të kontratave, lloji dhe përmbajtja e arsimit dhe trajnimit profesional, arsimit dhe trajnimit post - të mesëm, si edhe verifikim të të njëjtave, të diplomave, çertifikatave, dokumentacionit dhe evidencës. Në vetë Ligjin nuk ekziston klauzolë anti - diskriminuese dhe gjithashtu nuk ka disa masa më konkrete për përfshirjen e personave me pengesë mendore dhe trupore.

Ligji për arsim të të rriturëve përfshin dhe rregullon një segment nga mësimi i përjetshëm, por për fat të keq nuk paraqet zgjidhje për politikë të menduar, të përgjithshme dhe koherente për arsim të përjetshëm. Ky ligj nuk i përfshin aspak nevojat e personave me pengesë dhe mënyra e përfshirjes së tyre në arsimin formal dhe atë joformal. Në mënyrë plotësuese, në vetë Ligjin nuk keqziston klauzolë Anti-diskriminuese.

Arsimi parashkollor rregullohet me Ligjin për mbrojtje të fëmijëve me të cilin parashikohet se kopshti publik për fëmijë organizon kujdes dhe edukim të fëmijëve me pengesë (në ligj qendron: *fëmijë me pengesa në zhvillimin mendor ose në zhvillimin trupor*) në pajtueshmëri me llojin dhe nivelin e pengesës. Kujdesi dhe edukimi i fëmijëve me pengesë trupore kryhet në grupet e rregullta me ndihmë plotësuese të siguruar profesionale dhe programe të përshtatura, dhe për fëmijët me pengesë të moderuar në grupe të veçanta sipas programeve të veçanta. Në mënyrë plotësuese, në nenin 4 parashikohet parimi i mosdiskriminimit në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, që është i përpunuar më tej në mënyrë të detajuar në nenin 12. Pra, neni 12 paragrafi 1 parandalon çdo lloj forme të diskriminimit mbi bazë të pengesës *inter alia* (në ligj qendron: pamundësi) të fëmijës ose të prindit të tij ose kujdestarit ligjor.

⁴⁷ Shiko: Raport nga hulumtim: Zbatimi i teknologjisë informative asistuese në shkollat e rregullta fillore në Maqedoni, gjendjet dhe nevojat aktuale, Hapni dritaret, Shkup, mars, viti 2011, faq. 9-12.

Edhe pse terminologjikisht nuk është e përshtatshme që të përdoret pamundësi sepse bazohet plotësisht në pikëpamjen mjekësore të pengesës, që si model është i vjetëruar dhe në kundërshtim me

KDPP, megjithatë në mënyrë progresive në këtë dispozitë qendron që e parashikon diskriminimin nëpërmjet asociacionit, pra prindërve ose kujdestarëve të fëmijëve me pengesë. Në mënyrë plotësuese, parashikohet ndalimi i diskriminimit direkt dhe indirekt si edhe shqetësim (në ligj qendron: keqtrajtim) në realizimin e të drejtave dhe formave të mbrojtjes së fëmijëve që silltet në të gjitha institucionet publike dhe private si edhe persona fizikë që kryejnë punë të caktuara nga veprimtaria e kujdesit dhe edukimit të fëmijëve si veprimtari profesionale. Mund të arrihet në përfundimin se, kuadri ligjor është inkluziv dhe mjaft i qartë. Megjithatë, problemi shfaqet në zbatimin e tij përkatës në praktikë. Problemi shfaqet në disa nga kopshtet që në praktikë refuzojnë t'i regjistrojnë fëmijët me pengesë ose nëse tashmë janë regjistruar i çregjistrojnë për shkak të problemeve minore.⁴⁸ Vetëm në mënyrë ilustruese, të dhënat e Entit shtetëror për statistikë tregojnë se në vitin 2010 janë regjistruar 23.157 fëmijë nga të cilët vetëm 52 fëmijë janë me pengesë nga të cilët më së shumti në moshë 5 - vjeçare, pra gjithësej 28 fëmijë⁴⁹. Ky është numër shumë i vogël që e vërteton përfundimin e sipërpërmendur se kopshtet, në mënyrë direkte ose indirekte, e refuzojnë regjistrimin e rregullt të fëmijëve me pengesa (aftësi të kufizuara).

Edhe pse legjislacioni ekziston, megjithatë në praktikë personat me pengesë kanë nivel më të ulët të pjesëmarrjes në të gjitha fazat e procesit të arsimit, dhe veçanërisht në arsimin e mesëm dhe të lartë. Personat me pengesë mendore janë ata persona që më shpesh nuk e vazhdojnë arsimin e tyre në nivel më të lartë. Kjo përfshirje e vogël në procesin arsimor është e pjeshme për shkak të mosekzistimit të sistemeve të mjaftueshme për ndihmë dhe mbështetje, mos-aksesueshmëria fizike si edhe për shkak të ekzistimit të paragjytimeve të numërta ndaj këtyre personave në shoqëri. Vështirësia plotësuese është edhe mos-aksesueshmëria e institucioneve arsimore. Hulumtimi tregoi se nga gjithësej 334 shkolla fillore në vend, në raportin *Zbatim i teknologjisë asistuese informative në shkollat e rregullta fillore në Maqedoni, gjendje dhe nevoja aktuale* janë analizuar 238 shkolla (71,3%). Prej tyre platforma të pjerrëta për qasje në hyrje kishin 18,9% të shkollave, hapësira të brendshme të përshtatura (klasa dhe tualete) kishin 10,9% të shkollave, dhe asnjë shkollë nuk dispononte me ashensor të brendshëm. Nga shkollat e analizuar 74,3% të shkollave përdorin kompjutera në procesin mësimor, megjithatë vetëm 40,8 e nxënësve me pengesë përdorin kompjuter në të njëjtën bazë me nxënësit e tjerë në masë të madhe për shkak të mospërshtatjes së pajisjes kompjuterike (pajisje asistuese) dhe përshtatje softuerike.⁵⁰ Për sa i përket shkollave të mesme profesionale kur shkollohen persona me pengesë, rezultatet nga hulumtimet tregojnë se 59% e shkollave nuk kanë platformë të pjerrët, 78% nuk përdorin teknologji asistuese, dhe deri 65% pre tyre nuk disponojnë me hapësira të përshtatura.⁵¹

Fëmijët me pengesë të përfshirë në arsimin e rregullt fillor shpesh nuk e përfundojnë arsimin fillor por shkollohen vetëm disa vjet, me atë që disa fëmijë vazhdojnë me shkollimin në shkolla të veçanta dhe disa aspak nuk e vazhdojnë. Si arsye më të shpeshtë për lënien e parakohshëm të arsimit fillor janë kërkesat e prindërve që fëmija e tyre ta ndërpresë shkollimin, por numër i madh i fëmijëve që e kanë lënë arsimin për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore dhe mos patjes së kushteve dhe mundësive për shkollim të mëtejshëm në sistemin e rregullt arsimor. Gjithashtu, një pjesë e fëmijëve e lenë arsimin e rregullt edhe për shkak të rezistencës së prindërve dhe fëmijëve të tjerë, rezistencës së mësuesëve ose mospranimit nga nxënësit e tjerë. Problem i veçantë që e vështirëson arsimin e rregullt të fëmijëve me nevoja të posaçme është kuadri profesional që punon me këta fëmijë, pra vetëm rreth 10% e shkollave kanë kuadër të

⁴⁸ Shiko: Mirjana Najčevska, Bekim Kadriu, Ketii Jandrijska Jovanova, Biljana Čavkovska, Vjollca Mora Bajrami, *Të padukshëm për shoqërinë, Vlerësim të përgatitjes për ratifikim të Konventës për të drejtat e personave me pengesë*, Fondacioni shoqëri e hapur - Maqedoni, Shkup, viti 2011, faq. 48

⁴⁹ Enti shtetëror për statistikë, Numër .2.1.11.01, 2011.

⁵⁰ Shiko: *Raport për hulumtim: Zbatim i teknologjisë asistuese informative në shkollat e rregullta fillore në Maqedoni, gjendje dhe nevoja aktuale*, Hapni dritaret, Shkup, mars viti 2011, faq. 9-15.

⁵¹ Shiko: Adrijana Isahi-Paloshi, Lidushka Vasilevska, Lepa Trpçeska, Goran Spasovski, Radmila Stojkowska - Aleksova, David Crabtree, *Inkluzion në arsimin e mesëm profesional, udhëzues për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore*, Këshilli Britanik, Shkup, viti 2014, faq.69,

<http://www.britishcouncil.mk/sites/britishcouncil.mk/files/inclusion_in_secondary_vocational_education_handbook_mkd.pdf> E qasur në: 29.10.2014.

trajnuar profesional. Në të njëjtën kohë, shkollat nuk janë teknikisht dhe materialisht të pajisura në mënyrë të përshtatshme, fëmijët me nevoja të posaçme mësojnë mbi bazë të përmbajtjeve mësimore jopërkatese dhe të papërshtatura që nuk janë në mundësi t'i zotërojnë dhe nuk kanë libra të posaçëm, me çka do të mund të lehtësohej arsimi i kësaj kategorije të fëmijëve.

Tekst numër 6, Netpres, 19.09.2014

MËSUESIT NGA KARPOSH TRAJNOHESHIN PËR PUNË ME FËMIJË ME AUTIZËM

“Profesorë nga Amerika, Karen Robins dhe Rejçel Neal dhe profesorja Emilija Simonovska - Stojanovski nga shkolla e mesme amerikane Nova në Shkup, sot e përfunduan seminarin shtatëditor për autizëm dhe disleksion tek nxënësit. ... Qëllimi i seminarit është të trajnohen mësuesit për metodat dhe teknikat që përdoren për mësimin me nxënësit që janë të sëmurë nga autizmi dhe disleksioni, pra, si duhet të punohet dhe si duhet tu ndihmohet këtyre fëmijëve në procesin e mësimin dhe zotërimin e materialit edukues.”

Teksti numër 7, Utrinski vesnik, 26.09.2014

DYZET AUDIO-REGJISTRIME PËR PERSONA TË VERBËR TË PROMOVUARA NË BPU

“40 regjistrimet e para për nevojat e personave të verbër, zgjedhje nga tregimet më të njohura nga autorët më të njohur maqedonas dhe botërorë, radiodrama në gjuhën maqedonase dhe shqip, por edhe përmbajtje me karakter edukativ, janë promovuar dhe në Bibliotekën Popullore Universitare Sh. Kliment Ohridski në kuadër të projektit për zmadhim të fondit të këtij lloji të regjistrimeve në Departamentin e saj për persona të verbër dhe me shikim të dobët. Regjistrimet audio i caktoi Radioja Maqedonase - Radio Shkupi dhe i shtypi Ministria për punë dhe politikë sociale.”

Rekomandime:

- Individualizim të përjashtimit në pajtueshmëri me nenin 51 paragrafi 1 nga Ligji për arsim fillor kur nevojat e veçanta arsimore të fëmijës janë të tilla që ai duhet të ndjekë mësim në shkollë të veçantë fillore.
- Planet dhe programet e përshtatura për fëmijë me pengesë duhet të jenë me kualitet të barabartë si me ato që përdoren për arsim të fëmijëve pa pengesë. Në këtë drejtim, librat shkollorë dhe materialet e tjera shkollorë duhet të jenë të disponueshme në formë elektronike dhe në pajtueshmëri me konceptin për e-qasje (qasje elektronike).
- Vendosje të obligimit për shkollat që në klasat në të cilat ka nxënës me pengesë të angazhohen edhe ekipe profesionale që do të punojnë me fëmijën në pajtueshmëri me nevojat e tij individuale.
- Ndryshim të Ligjit për arsim fillor dhe Ligjit për arsim të mesëm në drejtim të përcaktimit në mënyrë të qartë të ndalimit të diskriminimit mbi bazë të pengesës pas saj duke u sjellë në: regjistrimin dhe kushtet për regjistrim të nxënësve në institucion të përshtatshëm arsimor; qasja e nxënësve në çdo lëndë mësimore, institucion ose dobi që e parashikon institucioni fillor arsimor; çdo kusht ose kriter tjetër për pjesëmarrje të nxënësit në mësim, ose çregjistrim të nxënësit nga institucioni, ose çdo sanksion tjetër të ndërmarrë kundër nxënësit.
- Ndryshim të Ligjit për arsim të mesëm në drejtim të lejimit të personave me pengesë që arsimin e tyre të mesëm ta fitojnë në sistemin e rregullt arsimor me bazë të barabartë me të tjerët. Pikërisht atje ku nuk ka mundësi për arsim të rregullt, duhet të sigurohet që programet mësimore të jenë të drejtuara ndaj profesioneve të sofistikuara më bashkëkohore që kërkohen nga tregu i përgjithshëm i punës.
- Është i nevojshëm edukim dhe trajnim i mësuesëve që e kryejnë mësimin e rregullt mësimor me fëmijët me pengesë. Në mënyrë plotësuese, është e domosdoshme që në çdo shkollë të jetë i angazhuar ekip profesional për punë me fëmijë me pengesa.

- Zmadhim të aksesueshmërisë në institucionet arsimore dhe intensivimit të procesit të futjes së teknologjisë informative asistuese në sistemin e rregullt arsimor të nxënësve me pengesë në mënyrë sistemike dhe të mirëmbajtur.

IV. SHËNDET

Fusha shëndet u veçua si segment shumë i rëndësishëm në jetën e personave me pengesë, duke filluar nga vetë mosqasja fizike në pjesën më të madhe të objekteve shëndetësore në shtetin tonë, mospatjen e infrastrukturës së brendshme përkatëse, nëpërmjet shërbimeve dhe trajtimeve të papërshtatshme, dhe deri tek marrëdhënia joshembullore e personave të punësuar mjekësorë me çka shkelet seriozisht e drejta e personave me pengesë të realizojnë mbrojtje shëndetësore të rregullt, në kohë dhe me kualitet.

I: Jo që vetëm jemi të diskriminuar, jemi shumë të diskriminuar. ... gomat i kam të vjetshme, para pak kohëve bleva nga 25 euro të brendshme dhe të jashtme. Këtu nuk ka, sepse nëse i ble këtu me lenë shenja të zeza nëpër shtëpi. Do të thotë duhet të shkoj deri në Nish të ble goma për 100 euro dhe plus 100 euro për rrugë, ato janë 200 euro, ato janë për një karrige me rrota. Së pari, nuk mund të rrih rrehat, në ato që i jep shteti ynë, së dyti shtrembërohen.

Burrë, 38 vjet, pengesë trupore

I: Para disa viteve caktova term për kontroll dhe telefonova në poliklinikën që të pyes nëse ka qasje. Fitova përgjigje se kanë qasje dhe prandaj caktova termin për filmim. Në ditën kur shkova për kontroll. Kishte platformë të pjerrët jashtë që të hyshtë në ndërtesë, megjithatë që të shkosh deri në ordinancë kishte dy shkallë për poshtë për të cilat nuk kishte platformë të pjerrët. Infermierja erdhi dhe na pyeti se për çfarë kemi ardhur, pasi i thashë më tha: "nuk ka qasje deri atje". Unë thashë se telefonova dhe se më thanë se ka qasje, ajo e thirri doktoreshën. Edhe pse unë isha e pranishme ato bisedonin njëra me tjetrën se ku të më dërgojnë në vend tjetër, domethënë që të caktoj edhe një herë termin, nuk e di nëse në poliklinikën në Bitpazar ose në poliklinikë tjetër ku ka qasje. Unë ju thashë se tashmë një muaj pres për trajtim, se kam organizuar transport dhe se sot do të filmohem. Pyetja nga ana ime ishte nëse do të më ndihmojnë ato të më zbresin nëpër ato dy shkallë ose të kërkoj persona nga jashtë, sepse dëshiroj sot të filmohem. Refuzuan të më ndihmojnë që të filmohem, unë kërkova shpejt persona nga jashtë që të më ndihmojnë, zbrita me ndihmën e tyre dhe e bënë filmimin.

Grua, 36 vjet, pengesë trupore

I: Kur në fakultet na detyruan të shkojmë në kontroll sistematik në një ambulancë që në thelbësi ishte e pa qasshme. Arrita përpara ambulancës dhe nuk mundesha t'i ngjij shkallët sepse ishte lart në kat, dhe nuk kishin ashensor. Nuk mundesha të shkoj, pas saj më mbaruan punë me atë që nuk më kontrolluan, nuk më kryen kontroll sistematik, më vendosën vetëm vulë në indeks por nuk e kryemë procedurën e nevojshme. Ajo ishte vetëm punë e përfunduar në mënyrë procedurale por kontroll sistematik nuk më kryen.

Burrë, 33 vjet, pengesë trupore

I: Unë jame rritur nëpër spitale dhe atje, normalisht, e di që ka infermiere, doktorë. Asnjërit nuk i lejojnë as shoqërim dhe asgjë, dhe ka ndodhur për shembull, të jem në dhomë ku të gjithë të tjerët mund të ngrihen, vetëm unë nuk mund të ngrihem, dhe infermiere nuk mund të thërrasësh, nuk ka shanse të thërrasësh infermiere. Nuk është e bukur, është shumë e pakëndshme kur duhet të lutësh ndonjë të sëmurë që është në krevat afër teje, por ai nuk e di se si të veprojë dhe nuk e di se si të të ndihmojë... Unë për atë kam shumë përvoja negative nga spitalet ... Nuk e di pse nuk lejojnë, me të vërtetë nuk e kam të qartë pse nuk lejojnë shoqëruet.

Grua, 29 vjet, pengesë trupore

I: Unë si person me invaliditet kam nevojë më shumë herë në vit të shkoj në mjekim banje Këtu hasem me një problem - që duhet të qendroj në spital që të më japin ndonjë dokument se me të

vërtetë kam nevojë për banjë, dhe a do të shkosh në banjë ose jo ajo është pikëpyetje, sepse çdokush nuk mund të qendrojë në spital ose ta nxjerrë atë dokument.

Grua 38 vjet, pengesë trupore

I: Pengesa më e madhe për mua është kur shkoj tek mjeku dhe nuk mund të komunikoj. Asnjëherë nuk mund të shkoj vetëm, duhet ndonjë nga familja ose sekretari sepse nuk mund të realizoj kontakt me administratën ose të kuptohem me doktorin për sëmundjen time ose për atë se cilat medikamente më duhen. Kurse me mjekun amë pak a shumë mund të kuptohem me vështirësi, dhe veçanërisht me doktor tjetër ose kur duhet të shkoj tek specialist nuk mund të merremi vesh në asnjë mënyrë.

Grua, 61 vjet, person me dëgjim të dëmtuar

E drejta e mbrojtjes shëndetësore, dhe disponueshmëria e së njëjtës për secilin nën kushte të barabarta është e parashikuar me nenin 39 nga Kushtetuta⁵². Nëse këtë nen e vendosim në korrelacion me ndalimin e përgjithshëm për diskriminim (neni 9) nga Kushtetuta, në të cilin pengesa nuk është e vendosur si bazë e mundshme për diskriminim, realizimi i të drejtës së garantuar për mbrojtje shëndetësore, me bazë të barabartë me të tjerët, bëhet e diskutueshme.

Nga aspekti i parimit të përgjithshëm të respektimit të të drejtave të njeriut, Ligji për mbrojtje shëndetësore⁵³ e rregullon të drejtën e çdo qytetari në standardin më të lartë të mundur për mbrojtje shëndetësore. Ligji i definon parimet mbi të cilat themelohet dhe ato: parimet e disponueshmërisë, efikasitetit, vazhdimësisë, drejtësisë, gjithpërfshirjes, si edhe parimit të sigurimit të trajtimit me kualitet dhe trajtimit të sigurtë shëndetësor. Parimi i disponueshmërisë është në korrelacion me parimin e drejtësisë së mbrojtjes shëndetësore, që në Ligj është e vërtetuar se realizohet me ndalim të diskriminimit gjatë ofrimit të mbrojtjes shëndetësore në lidhje me invaliditetin *inter alia* psikik ose trupor.

Nëpërmjet Ligjit për sigurim shëndetësor⁵⁴, qytetarëve u sigurohen shërbime shëndetësore në mbrojtjen primare, specialistike - konsultuese dhe mbrojtjen spitalore (afatshkurte dhe afatgjatë) dhe shërbimet shëndetësore nëpërmjet programeve qeveritare për mbrojtje parandaluese dhe kuruese shëndetësore. Përkrah paketave themelore shëndetësore, mbrojtja tradicionale shëndetësore⁵⁵ është e largët për personat me pengesë.

Ligji për mbrojtje të të drejtave të pacientëve⁵⁶ në nenin 2 dhe nenin 5 i rregullon aspektet individuale të së drejtës për shëndet, pra të drejtën e çdo qytetari në standardin më të lartë të mundshëm të mbrojtjes shëndetësore, duke pëcaktuar se mbrojtja shëndetësore duhet të jetë me kualitet dhe e vazhdueshme dhe në pajtueshmëri me arritjet aktuale në shëndetësi, e përshtatshme për nevojat individuale të pacientit, me mungesë së keqpërdorimit psikik dhe fizik dhe me respektim të plotë të dinjitetit dhe personalitetit të tij dhe në interesin më të mirë të tij. Parimi i mosdiskriminimit në realizimin e të drejtave është i rregulluar me nenin 5, paragrafi 2 ku pengesa nuk është e përmendur në bazat e mbrojtjes. Në mënyrë plotësuese, të drejtë për informacion ka edhe pacient me aftësi të zvogëluar të përhershme për gjykim, në pajtueshmëri me gjendjen e tij fizike, mendore dhe psikike, si edhe kujdestari i tij ose përfaqësuesi ligjor (neni 11). Dispozita e tillë e vendosur është e mirë, por për shkak të mungesës së trajnimeve për komunikim dhe qasje ndaj personave me pengesë, në praktikë e njëjta ajo është e vështirësuar.⁵⁷

Në klauzolën për mosdiskriminim, në Ligjin për shëndetësi mendor⁵⁸, përcaktohet se: “[d]iskriminimi është çdo lloj izolimi, shkyçje, largim ose trajtim tjetër që ka efekt të lëndimit ose shkeljes së barazisë në gëzimin e të drejtave, përveç në raste të përcaktuara me këtë ligj (neni 4 pika 4, dhe

⁵² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (dhe XXXII amendamentet), *Faqja e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë*, <<http://sobranie.mk/WBStorage/Files/UstavnaRmizmeni.pdf>> E qasur në: 19.10.2014.

⁵³ [Ligji për mbrojtje shëndetësore, G.Z. nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13.](#)

⁵⁴ Ligji për sigurim shëndetësor, [G.Z. nr. 65/12, 16/13, 91/13.](#)

⁵⁵ Shiko: *Hendikep – copëza e figurës që mungon, Tregim i gjendjes së personave me hendikep*, Polio plus, viti 2012, faq. 60- 64.

⁵⁶ Ligji për mbrojtje të të drejtave të pacientëve, [G.Z. nr. 82/08.](#)

⁵⁷ Shiko: *Të drejtat e pacientëve me fokus ndaj personave me pengesë intelektuale*, ESE, viti 2011, faq.6,

<<http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/ESE%20Intelektualna%20poprecenost.pdf>> E qasur në: 05.11.2014.

⁵⁸ Ligji për shëndetësi mendor, [G.Z. nr. 71/06.](#)

në lidhje me nenin 7-6), personi me sëmundje mendore ka të drejtë të mbrojtjes nga çfarëdo lloj forme të keqtrajtit, poshtërimit dhe abuzimit dhe nuk duhet të jetë i diskriminuar për shkak të gjendjes me shëndetin e tij mendor”. Me Ligjin është përcaktuar e drejta “[t]ë respektohen personi, dinjiteti dhe privatësia e çdo personi me sëmundje mendore. Personi me sëmundje mendore ka të drejtë mbrojtjeje nga çfarëdo lloj forme të keqtrajtit, poshtërimit dhe abuzimit dhe nuk duhet të jetë i diskriminuar për shkak të gjendjes me shëndetin e tij mendor” (neni 7).

Praktika për qasjen ndaj personave me pengesë mendore dhe trajtimin e tyre nëpër institucione tregon tjetër pamje. Domethënë, gjatë vizitës dhe kontrollit në punën e spitaleve Psikiatrike në Shkup dhe Demir Hisar, Avokati i popullit⁵⁹ ka arritur në gjetjen se ekzistojnë: “kushte të papërshtatshme të hapësirave për vendosje të përdoruesëve të shërbimeve, si edhe mosekzistimin e numrit të mjaftueshëm të kuadrit përkatës mjekësor dhe kuadrit tjetër për zbatim të mënyrave bashkëkohore të mjekimit dhe punës me përdoruesit e shërbimeve për shkak të përmirësimit për jetë të pavarur ose për kthim në familje; kuadër i edukuar dhe i trajnuar në mënyrë të pamjaftueshme për zbatim të mënyrave bashkëkohore të mjekimit të personave të sëmurë mendorë; mungesë të mjeteve për zbatim të reformave që duhet të kontribuojnë për ndryshim të mënyrës klasike të mjekimit dhe zvogëlim të numrit të përdoruesëve që periudhë më të gjatë mbeten të jetojnë në kushte spitalore të harruar nga familja dhe nga shoqëria, pa rehabilitimin dhe aftësimin e tyre për jetë të pavarur ose për jetë jashtë nga kushtet spitalore”.

Barazia dhe mosdiskriminimi, është i parashikuar edhe me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, i shpjeguar më lart, me zbatim duke përfshirë edhe fushën e sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore (neni 4, paragrafi 1, pika 3).

Me rregulloren për indikacionet për realizim të së drejtës për pajisje ndihmëse ortopedike dhe pajisje të tjera⁶⁰ janë rregulluar rregullat mbi bazë të së cilave realizohet e drejta e protezave, pajisjeve ndihmëse ortopedike dhe pajisjeve të tjera, pajisjeve ndihmëse sanitare dhe materiale dhe mjete dentare, të përpunuara nga material standard, mënyra e realizimit, si edhe lartësia e pjesëmarrjes së personave të siguruar me çmimin e atyre pajisjeve ndihmëse (neni 1). Nga aspekti i realizimit të së drejtës së karriges me rrota për invalidë, personat e siguruar kanë të drejtë vetëm për një karrige dhomë me rrota (neni 13 paragrafi 1) përdersia personi është në marrëdhënie pune, ose nëse fëmija është në shkollim të rregullt deri në moshë 18 vjeçare ose deri në moshë 26 vjeçare. Përkrah karriges me rrota të dhomës kanë të drejtë edhe për karrige me rrota për në terren me përdorim manual. (neni 13 paragrafi 2). Nëse ka nevojë për karrige me rrota për në terren ose karrige me rrota për invalidë me elektromotor vlerëson komisioni mjekësor i Fondit (neni 13 paragrafi 3), dhe afati i zgjatjes së karrigjeve është të paktën 60 muaj, dhe për fëmijë deri 18 vjet - 36 muaj - (neni 15), dhe për jastëkun antidekubital 36 muaj. Pas përfundimit të përdorimit të karriges me rrota, personi i siguruar ose anëtar i familjes së tij është/janë

të obliguar që karrigen ta kthejnë në Fondin (neni 16) në pajtueshmëri me deklaratën e nënshkruar⁶¹ për përdorim shtëpiak nga ana e përdoruesit, në afat prej 30 ditë. Nëse personi nuk e kthen karrigen, është i obliguar që Fondit t'i kompensojë dëm prej 80% të vlerës së pajisjes ndihmë, në ditën e verifikimit. Të ngjashme janë kushtet edhe për pajisjet e tjera ndihmëse.

Me rregulloren për rehabilitim të specializuar mjekësor si mjekimi i vazhduar spitalor⁶², nën nenin 7 paragrafi 1, parashikohet se personi i siguruar mund të realizojë të drejtë për rehabilitim të specializuar mjekësor vetëm si mjekim të vazhduar spitalor dhe mund të zgjasë të shumtën 21 ditë. Përjashtim janë fëmijët me paralizë cerebrale deri në moshë tre-vjeçare, dhe për ta rehabilitimi mjekësor mund të zgjasë deri 30 ditë dhe ajo deri katër herë gjatë vitit (neni 12

⁵⁹ Shiko: Raport nga kontrolli i kryer në Organizatën publike shëndetësore Spitali psikiatrik “Shkup” - Shkup, Departamenti për mbrojtje jashtë-spitalore dhe përparim të shëndetit mendor “Prolet” - Shkup dhe Spitali Psikiatrik “Demir Hisar”, Avokati i popullit, viti 2006, faq.2 <<http://ombudsman.mk/upload/documents/JZO-mak.pdf>> E qasur në: 20.10.2014.

⁶⁰ Rregullorja për indikacionet për realizim të së drejtës për pajisje ndihmëse ortopedike dhe pajisje të tjera ndihmëse, <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/1.Pravilnik_za_indikaciite_za_ostvaruvanje_na_pravoto_na_oropedski_i_drugi_pomagala_precisten_tekst_115_od_2007.pdf> E qasur në: 20.10.2014.

⁶¹ Informacion për personat e siguruar në lidhje me procedurën për realizim të së drejtës për pajisje ndihmëse ortopedike dhe pajisje të tjera në barë të FSSHM, <<http://www.zplrm.mk/Prevezmanja/Informacija%20osigurenici.pdf>> E qasur në: 20.10.2014.

⁶² Rregullore për rehabilitim të specializuar mjekësor si mjekim i vazhduar spitalor, G.Z nr. 25/00, 34/00, 96/00, 50/01, 11/02, 31/03, 84/05, 37/06, 18/07, 36/07, 82/08, 98/08, 6/09, 67/09, 50/10, 156/10, 53/11, 26/12, 16/13, 91/13, 187/13, 43/14, 44/14, 97/14, 141/14.

paragrafi 1), ndërsa për fëmijët mbi moshën tre-vjeçare deri në moshën katërbëdhjetë-vjeçare mund të zgjasë deri në 30 ditë dy herë gjatë vitit (neni 12 paragrafi 3). E drejta për shoqëruar realizohet në pajtueshmëri me Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e realizimit të të drejtave dhe obligimeve nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe sillet vetëm për fëmijë deri në moshë 3 vjeçare (neni 9-10). Vendosja e tillë vetëm e kufizon në mënyrë plotësuese dhe/ose e pamundëson të drejtën e realizimit të mbrojtjes dhe trajtimit efektiv shëndetësor.

Për shkak të kufirit të moshës, dhe trajtimi i personave me pengesë deri në moshë 26 vjeçare si fëmijë, qytetarët me pengesë përballen me qasje të kufizuar në sigurimin e mbrojtjes shëndetësore pa pagesë, mjekimit, trajtimit, pajisjet ndihmëse dhe medikamentet. Pra, Ligji për sigurim shëndetësor siguron lirim nga pjesëmarrja gjatë përdorimit të shërbimeve nga mbrojtja shëndetësore vetëm për fëmijë, pra për persona me pengesë deri në moshë 26-vjeçare, por jo edhe pas saj.

Tekst numër 8, Biznis, 29.12.2014

FSSHM NGA VITI 2015 ME SURPRIZA TË REJA PËR PËRDORUESIT

“Tre pajisje ndihmëse ortopedike nga 1 janari do të jenë në barë të Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë. Do të futet karrige me rrota për invalidë me elektromotor - skuter për personat nga 7 deri 26 vjet dhe më të moshuar se 65 vjet me invaliditet të përhershëm.”

Tekst numër 9, Vistina.mk, 14.12.2014

NOTI PËR KUJDES DHE NDIHMË MË TË FUQISHME PËR FËMIJËT ME SINDROM DOWN

“Nga fillimi i vitit 2015 fillon realizimi i projektit - pilot për promovim të aktivitetit fizik dhe zhvillim të aftësive sportive për not tek fëmijë me sindrom Down. Aktivitetet do të realizohen nëpërmjet Entit për mjekësi fizikale dhe rehabilitim - Shkup, me organizim të orëve për not për fëmijët me sindrom Down. Fëmijët që do t'i frekuentojnë orët për trajnim, para fillimit do të duhet të kryejnë kontroll të përshtatshëm shëndetësor”.

Si një nga arsyet për përdorimin joefikas dhe joefektiv të shërbimeve shëndetësore është edhe mosqasja fizike në numër të madh të institucioneve shëndetësore, midis të cilave edhe në vetë Ministrinë e shëndetësisë, si edhe në Fondin për sigurim shëndetësor, siç theksoi edhe numër i madh i të anketuarëve të përfshirë.

Një nga përfundimet në punën hulumtuese specialistike *Shërbimi patronazh tek fëmijët me nevoja të posaçme*⁶³, tregojnë se infermieret e patronazhit kanë nevojë për nivel më të lartë të edukimit për trajtim dhe rehabilitim të fëmijëve me nevoja të veçanta në kushte shtëpiake, si edhe ajo që kanë nevojë për koordinim dhe bashkëpunim më të madh në shërbimin patronazh me institucione të tjera shëndetësore, sociale dhe arsimore, me qëllim sigurimin e komunikimit më kualitativ në marrëdhënien punëtor shëndetësor - klient. 57% e prindërve të intervistuar, në *Raport nga hulumtimi për gjendjet në lidhje me implementimin e KDPP të KB*⁶⁴ nuk janë të kënaqur nga shërbimet e mbrojtjes shëndetësore, deri 100% e prindërve të personave me pengesë intelektuale mbi 26 vjet e drejtojnë qasjen selektive në sigurimin e mbrojtjes shëndetësore, mjekimin, trajtimet dhe medikamentet pa pagesë, si edhe ajo që sistemi i vlerësimit të nevojave të veçanta të personave me pengesa në zhvillimin fizik dhe psikik nuk është i zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme dhe është i vjetëruar. Stereotipet dhe mendimet janë pengesë plotësuese⁶⁵ në realizimin e të drejtave nga mbrojtja shëndetësore tek personat me pengesë, ku të njëjtët janë shpesh të përbuzur dhe i konsiderojnë si aseksualë. Në mënyrë plotësuese me këto gjetje janë edhe drejtimet për domosdoshmërinë e shkëputjes së serviseve për habitacion dhe rehabilitim që

⁶³ Shiko: Liljana Ivanovska, Punë specialistike - *Shërbimi i patronazhit tek fëmijët me nevoja të posaçme*, viti 2010, faq.4-5, <https://eprints.ugd.edu.mk/475/1/Specialisticki_Liljana_Ivanovska.pdf> E qasur në: 26.10.2014.

⁶⁴ Shiko: *Raport nga hulumtimi për gjendjet në marrëdhënie me implementimin e Konventës së KB për të drejtat e personave me pengesë*, Mesazh, viti 2012, faq.15.

⁶⁵ Shiko: *Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me pengesë trupore - Raport nga vlerësimi për nevoja dhe shërbime*, Hera, viti 2012, faq.61-62.

janë mbështetje e domosdoshme në sigurimin e jetës së pavarur dhe me dinjitet të personave me pengesë, si edhe shpenzimet e mëdha që jepen për pajisje ndihmëse pa kualitet.⁶⁶

Rekomandime:

- Ndryshim të Ligjit për sigurim shëndetësor dhe Ligjit për mbrojtje shëndetësore në drejtim të lejimit të personave me pengesë që ta përdorin mbrojtjen shëndetësore terciare pa pagesë në pajtueshmëri me nevojën e lindur nga pengesa.
- Ndryshim të Ligjit për mbrojtje të të drejtave të pacientëve në drejtim të përcaktimit të qartë të ndalimit të diskriminimit mbi bazë të pengesës si edhe përfshirje të detyrueshme të personit me pengesë në mekanizmat për mbrojtje të të drejtave të pacientëve.
- Zhvillim dhe marrje të kuadrit rregullues për lloje të shërbimeve shëndetësore nga më të ndryshmet primare, dytësore dhe terciare që do të mundësojë nivel të lartë të disponueshmërisë, dhe mbështetje të personave me pengesë dhe personave me sëmundje mendore për përfshirjen e tyre në bashkësi, si edhe shkëputjen dhe zhvillimin e serviseve për rehabilitim dhe habitacion dhe sigurim të shërbimeve me kualitet të barabartë.
- Sigurim të qasjes së papenguar dhe disponueshmërisë në të gjitha objektet shëndetësore, duke përfshirë edhe Ministrinë e shëndetësisë, Fondin për sigurim shëndetësor, të gjitha institucionet shëndetësore, si edhe klinikat, spitalet, shtëpitë shëndetësore, entet, ordinancat, farmacitë etj. Në mënyrë plotësuese, është e nevojshme përfshirje e personave me pengesë në trupat rregullues për lëshim të licencës për punë të institucioneve shëndetësore.
- Ndryshim të Ligjit për furnizim të medikamenteve dhe pajisjeve me futje të standardeve për qasje dhe disponueshmëri të medikamenteve dhe pajisjeve që lëshohen në qarkullim.
- Ndryshim të Ligjit për sigurim shëndetësor me mundësim të përdorimit të vazhdueshëm, pa asnjë lloj kufizimi nga mosha, për pajisjet ndihmëse ortopedike me kualitet dhe funksionalitet më të lartë, në pajtueshmëri me nevojën e qytetarëve me pengesë.
- Edukim të detyrueshëm dhe trajnime të personelit shëndetësor për qasje dhe komunikim me personat me pengesa, në serviset për patronazh, si edhe të atyre që janë të përfshirë në spitalet psikiatrike.
- Përfshirje të detyrueshme të çështjes së pengesës në programet e reja qeveritare “Alo doktor”, “Termi im” dhe shërbimet e reja telemjekësore që planifikohen të sillen.
- Ndryshim të dispozitave me të cilat është e rregulluar procedura qytetare për akomodim të personave në institucion psikiatrik, edhe akomodimin vullnetar edhe akomodimin me vendim nga gjykata.

⁶⁶ Shiko: Elena Koçoska, Zvonko Shavreski, Projekt hulumtues: Çmimi i bërjes, Polio plus, viti 2011, faq.39, <www.polioplus.org.mk> E qasur në: 21.10.2014.

V. PUNË DHE PUNËSIM

I: Nga aspekti i punësimit, premtojnë do të jetë kështu, do të jetë ashtu, do tju marrim në punë si invalidë, dhe pasi do tju marrin në punë vetëm shohin t'i shfrytëzojnë mjetet për invalidët. T'i shfrytëzojnë ato përfitime që u takojnë punëdhënësve, derisa invalidi nuk pyetet aspak nëse është i kënaqur në përgjithësi nga rroga, me vendin e punës...do të thotë, invalidi shihet vetëm që të shfrytëzohet maksimalisht sa të mundet.

Burrë, 34 vjet, pengesë trupore

I: I zemëruar, shumë i zemëruar sepse nuk mund të punosh. Nuk kërkon ndihmë sociale, mundohesh të arrish diçka vetë, megjithatë këtu ka shumë obstrukcione në milionë anë.

Burrë, 33 vjet, pengesë trupore

I: Unë 3 vjet punoja në shoqëri për mbrojtje nga viti 2010 deri 2013. Vitin e parë ishte mirë, nuk mund të ankojem, kishte rrogë të rregullt. Pastaj filloi mos pagimi i kontributeve dhe rrogës. Vitin e fundit kisha edhe problem - nuk dëshironte të më çregjistronte, sepse kanë interes nga ligji për punësim të personave invalidë.

Burrë, 32 vjet, pengesë trupore

M: Më thoni cilat janë barrierat ose sfidat më të vështira me të cilat përballeni në jetë?

I: Më shumë në këtë shoqëri për invalidët ka shumë barriera - nuk ka aksesueshmëri, ka diskriminim dhe ka probleme edhe në punësimin ... Gjatë punësimit personat me invaliditet nuk kanë asnjë përparësi, nuk krijohen kushte për punësimin e tyre - ata janë të injoruar edhe përkrah ligjit që ofron përparësi.

Burrë, 57 vjet, pengesë trupore

Kur bëhet fjalë për të drejtën e punës së personave me pengesa nga standardet ndërkombëtare përkrah KPLH jashtëzakonisht i rëndësishëm është edhe pakti Ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Në kuadër të njoftimit të rregullt pas këtij Pakti, veçanërisht të rëndësishme janë pikëpamjet përkufizuese të Komitetit për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore të marra merastin e raportit fillestar për Republikën e Maqedonisë për zbatim të MPESKP nga viti 2006⁶⁷. Pra, komiteti drejton kritika konstruktive në lidhje me normën jashtëzakonisht të lartë të papunësisë, veçanërisht në lidhje me personat *inter alia* me pengesë mendore dhe trupore (paragrafi 15) dhe kërkon nga shteti në raportin e mëtejshëm të përfshijë të dhëna statistikore për papunësinë të shpërndara edhe sipas pengesës (paragrafi 35).

Kushtetuta, në nenin 32 të saj e parashikon të drejtën e punës dhe të drejtat e saj të ngjashme. Kjo e drejtë është me destinim të përgjithshëm dhe parashikon se secili [duke përfshirë edhe personat me pengesë] ka të drejtë për punësim, zgjedhje të lirë të punësimit, mbrojtje gjatë punës dhe siguri materiale gjatë kohës së papunësisë së përkohshme (paragrafi 1). Në mënyrë plotësuese, përmendet se secilit, nën kushte të barabarta, i është i disponueshëm çdo vend pune (paragrafi 2), dhe ku çdo i punësuar ka të drejtë për fitim përkatës (paragrafi 3) si edhe të drejtë për pushim të paguar ditor, javor, dhe vjetor dhe nga të gjitha këto të drejta të punësuarit nuk mund të heqin dorë (paragrafi 4). Të njëjtat, më tej rregullohen me ligjin për kontratën kolektive

⁶⁷ Concluding observations of the Committee on Economic Social and Cultural Rights, UN Doc. E/C.12/MKD/CO/1, from 24 November 2006, <<http://www2.ohchr.org/english/bodies/cescr/docs/E.C.12.MKD.CO.1.pdf>> E qasur në: 29.10.2014.

(paragrafi 5). Neni 35 paragrafi 3 parashikon se personave invalidë shteti u siguron mbrojtje të veçantë si edhe kushte për përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

Veçanërisht të rëndësishëm janë Ligjet për marrëdhënie pune dhe Ligji për punësim të personave invalidë si *lex specialis*, i shpjeguar më poshtë. Neni 6 nga Ligji për marrëdhënie pune e parandalon në mënyrë të qartë diskriminimin në përgjithësi, duke përfshirë edhe sipas bazës së *invaliditetit* të kryera nga ana e personave fizikë dhe juridikë në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat.

I njëjti i parandalon të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin direkt (neni 7 paragrafi 2), diskriminimin indirekt (neni 7 paragrafi 3) dhe shqetësimin (neni 9 dhe 9-a) të kandidatit për punësim dhe të punëtorit. Kritika është që Ligji nuk e parashikon instruksionin për diskriminim dhe nuk i parandalon në mënyrë të qartë as njoftimet diskriminuese ose deklaratat mbi bazë të pengesës. Domethënë, Ligji në nenin e tij 24 paragrafi 1 i parandalon në mënyrë të qartë njoftimet ose deklaratat diskriminuese vetëm mbi bazë të gjinisë, duke përmendur se: “[p]unëdhënësi nuk duhet që vendin e lirë të punës ta publikojë vetëm për burra ose vetëm për gra, përveç nëse gjinia e përcaktuar është kusht i domosdoshëm për kryerjen e punës”. Kjo në të ardhmen duhet të ndryshohet dhe të pajtohet me standardet ndërkombëtare antidiskriminuese.

Veçanërisht interesante për shqyrtim është edhe dispozita nga Ligji për marrëdhënie pune në të cilën përmendet se “[g]jatë lidhjes së kontratës për punësim kandidati nuk është i obliguar të dorëzojë dëshmi për aftësinë shëndetësore, përveç nëse punëdhënësi në llogari të tij do ta dërgojë në kontroll shëndetësor” (neni 25 paragrafi 5), që plotësohet me paragrafin e mëtejshëm që thotë: “[k]ontrollin e dijes, pra aftësisë së kandidatit ose vërtetimin e aftësive shëndetësore të kandidatit nuk duhet të sillen në rrethanat që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejtë me punën dhe vendin e punës për të cilën lidhet kontratë për punësim” (neni 25 paragrafi 6). Këto dispozita në tërësi i plotësojnë standardet për mbrojtje nga diskriminimi të personave me pengesë, megjithatë të njëjtat përjashtohen nëse merren parasysh dispozitat, për shembull, nga Ligji për zyrtarë administrativë (që sillen në punësimin në sektorin publik) ku parashikohet *aftësia e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës* si një nga kushtet për punësim (neni 31 paragrafi 1 pika 4). E vendosur kështu kjo dispozitë, edhe pse në dukje neutrale, megjithatë, ka efekt disproporcional negativ për personat me pengesë sepse, i gjithë grupi *a priori* është i pamundësuar në konkurimin për punësim. Edhe pse për disa grupe të personave me pengesë ky kriter do të mund të ishte valid, megjithatë, për personat me pengesë trupore ose sensore ky kriter është tepër diskriminues. Prandaj, duhet të bëhet shkëputje e gjendjes shëndetësore dhe aftësisë nga gjendja e punës dhe aftësisë tek personat me pengesë, dhe të njëjtët të mos barazohen.⁶⁸

Përkrah dispozitave antidiskriminuese, Ligji parashikon edhe mbrojtje të veçantë për personat me pengesë *inter alia* (nenet 122, 161-162, 164 dhe 169, 177-178). Përkrah mbrojtjes së veçantë të punëtorëve - invalidë, Ligji ofron edhe mbrojtje të punëtorëve - prindër të fëmijëve me pengesë. Për shembull, në pajtueshmëri me Ligjin një nga prindërit e fëmijës me probleme në zhvillim dhe nevoja të posaçme arsimore ka të drejtë të punojë me gjysmën e orarit të plotë të punës, dhe kjo kohë e shkurtuar do të konsiderohet si orar i plotë pune (neni 169). Gjithashtu, në pajtueshmëri me nenin 137 paragrafi 3 nga Ligji për marrëdhënie pune, invalid *inter alia*, punëtor me të paktën 60% dëmtim trupor dhe punëtor që kujdeset dhe ruan fëmijë me mangësi trupore ose shpirtërore ka të drejtë për edhe tre ditë pushim vjetor plotësues.

⁶⁸ Shiko: Zhaneta Poposka, *Punësim të personave me hendikep në Republikën e Maqedonisë (analizë juridike)* Polio plus, Shkup, viti 2013, faq.23-24.

Tekst numër 11, Faktor, 07.10.2014

TË DREJTAT E FËMIJËVE ME PENGESË NË ZHVILLIM GJENDEN VETËM NË LETËR

“Është i vështirë fati i familjeve që kanë fëmijë me pengesë në zhvillim... Njëra prej tyre është edhe familja Donevski që ka djalë 25-vjeçar me pengesë të rëndë fizike dhe psikike në zhvillim. Nëna Olivera Donevska, që është e punësuar, deri tani nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për orar pune të shkurtuar prej 4 orë, sepse vjehri dhe vjehrra e ndihmonin rreth fëmijës. Ata mund ta ruajnë derisa ajo ka qënë në punë. Por, pas vdekjes së vjehrit, ajo ka vendosur ta aktivizojë vendimin për orar pune të shkurtuar. Këtë vendim, thotë Olivera, e kanë fituar që kur djali i tyre ka qënë bebe, në vitin 2009 i kanë rinovuar formularët për përdorim eventual, por tani nuk kanë arritur ta realizojnë këtë të drejtë.”

Këtu, në mënyrë të pashmangshme duhet të përmendet edhe Ligji për punësim të personave invalidë, që i . Në nenin 1 nga Ligji përmendet se “[m]e këtë ligj rregullohen kushtet e veçanta për punësim dhe punë të personave invalidë kur kryejnë profesion ose veprimtari në mënyrë të pavarur, tek punëdhënës ose ka funksion të punëdhënësit, si edhe kushtet për themelim dhe përfitimet për punë në shoqëri tregëtare për punësim të personave invalidë”. Praktika tregon se me të nuk janë përfshirë të gjitha kategoritë e personave me pengesë, veçanërisht jo ata që kryejnë veprimtari ose profesion në mënyrë të pavarur, pra merren me aktivitete të lira si, për shembull: avokat, mjek, noter etj. që janë të pamundësuar që t'i realizojnë përfitimet që i lejon Ligji. Pozitive është që me nenin 4 nga Ligji parashikohen numër i madh i masave stimuluese për përmirësim të kushteve për punësim të personave me pengesë, siç janë: ndarja e mjeteve të pakthyeshme për punësim me kohë të pacaktuar të personit të papunësuar me pengesë, përshtatje të vendit të punës në të cilën do të punojë personi përderisa ajo është e nevojshme, furnizim të pajisjeve, lirim nga tatimet dhe sigurim të mjeteve për kontribute, dhe mbështetje financiare për punim. Masat stimuluese janë të valorizuara në numrin e rrogave mujore që si mjete të pakthyeshme paguhen nga Fondi i veçantë i formuar në pajtueshmëri me këtë ligj. Këto janë në mënyrë parimore zgjidhje të mira që klasifikohen si masa afirmuese. Megjithatë, të njëjtat duhet të kenë mundësi që të rishqyrtohen nga ana e gjykatës në rastin konkret, me qëllim që të vlerësohet rezultati i tyre plotë, veçanërisht duke pasur parasysh se ekziston shqetësim serioz për keqpërdorim të mundshëm nga ana e punëdhënësve, veçanërisht të shoqërive mbrojtëse.

Krijimi i mundësive për punësim të personave me pengesë në mënyrë të pashmangshme përfshin edhe sigurim të përshtatjes përkatëse për këtë grup të personave në procesin e intervistimit gjatë punësimit, si edhe në vendin e punës. (për më shumë informacione shiko më lart në pjesën I. Dispozita të përgjithshme me aplikim horizontal, 2.1. Përshtatje e arsyeshme).

Nga aspekti i antidiskriminimit, është e diskutueshme dispozita në nenin 4-a paragrafi 5. Domethënë, e njëjta parashikon se “[p]erson invalid mund të jetë punëdhënës ose të kryejë punë të personit përgjegjës tek punëdhënësi, përderisa fiton mendim pozitiv nga Komisioni pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale ... “Edhe pse, konsiderohet se qëllimi i ligjvënësit nuk ka qënë që t'i diskriminojë personat me pengesë, por ka vepruar në mënyrë mbrojtëse ndaj tyre, megjithatë, dispozita e vendosur në këtë mënyrë me të cilën kërkohet gjetje dhe mendim për aftësi për personin me pengesë për kryerje të funksioneve udhëheqëse është diskriminuese dhe duhet të anulohet. E njëjta paraqet shembull shkollor për diskriminim në formë shfaqëse të shqetësimit, të themeluar mbi ligj.

Veçanërisht interesante për shqyrtim është çështja e punëtorive mbrojtëse. Me ligji dhe me të dyja rregulloret që dalin prej tij rregullohet çështja e punësimit të personave me pengesë në punëtoritë mbrojtëse. Shoqëritë mbrojtëse lirohen nga pagesa e tatimit mbi fitimin dhe të gjitha taksat nga fitimi, dhe të punësuarit në shoqërinë mbrojtëse, që nuk janë persona me pengesë, lirohen nga pagesa e tatimit personal mbi fitimin dhe mjetet për kontribute për sigurim pensional dhe invalidor i siguron shteti. Është pozitive që të përmendet që angazhimi në punëtoritë mbrojtëse konsiderohet si punësim i rregullt në pajtueshmëri me legjislacionin kombëtar. Megjithatë, nuk duhet të harrohet se punësimi në shoqëritë mbrojtëse duhet të jetë zgjidhje kalimtare ndaj punësimit të plotë në tregun e hapur të punës të personave me pengesë dhe ku nuk duhet ta shmangë këtë të dytën si edhe punësimin në sektorin publik.

Aktualisht po punohet në ndryshime të Ligjit për punësim të personave me invaliditet⁶⁹ në drejtim të futjes së sistemit të kuotave për punësim të personave me pengesë si edhe rregullim ligjor të rehabilitimit profesional të këtyre personave. Domethënë, propozohet që çdo ndërmarje nga sektori publik dhe ai privat që ka mbi 35 të punësuar të ketë obligim të punësojë person me pengesë dhe pastaj kuota të jetë jo më pak se 2% dhe as më shumë se 6% nga numri i përgjithshëm i të punësuarëve, në varësi të veprimtarisë që e kryen punëdhënësi (propozim - neni 7). Ky obligim nuk është i parashikuar për ndërmarrjet e reja të themeluara deri në përfundimin e muajit të 24 nga themelimi si edhe i për ato të huaja, për përfaqësi diplomatike e konsullore dhe shoqëri. Nëse punëdhënësi nuk punëson person me pengesë dhe ka obligim të tillë, është i detyruar të paguajë kompensim monetar (propozim- neni 8).

Pozitive është edhe në definimin e personave me pengesë (të ashtuquajtur persona me invaliditet) zbatohet qasja e themeluar në modelin social (propozim neni 2 paragrafi 1), por paraqet problem nevoja për dëshmi të pengesës (propozim-neni 6 paragrafi 1 pika 1). Për fat të keq, projekt ligji nuk i tejkalon mangësitë e lidhura me dispozitën e diskutueshme në nenin 4-a paragrafin 5 me të cilin kërkohet mendim pozitiv nga Komisioni nëse personi me pengesë dëshiron të jetë punëdhënës ose të kryejë punë të personit përgjegjës tek punëdhënësi (propozim-neni 11 paragrafi 4). Mbeten edhe të gjitha dispozitat e lidhura me shoqëritë mbrojtëse, pastaj duke e lënë mundësinë për integrim të plotë në tregun e hapur të punës të personave me pengesë.

Tekst numër 10, Kapital, 25.12.2014

KOMPANITË E TREMBURA NGA NDRYSHIMETE REJA - OSE TË PUNËSOJNË PERSONA ME INVALIDITET OSE TË PAGUAJNË 150 EURO NË MUAJ

“Më shumë se 3.000 firma në Maqedoni do të duhet të punësojnë të paktën një person me hendikep ose në muaj të paguajnë kompensim prej 150 eurosh. Sipas informacioneve të fundit të Entit Shtetëror për statistikë, në vend ka gjithësej 3.278 kompani që kanë më shumë se 35 persona të punësuar, për të cilat në thelbësi edhe sillet obligimi i ri ligjor që del nga projekt-ligji i ri për punësim të personave me hendikep. Pra e llogaritur sipas kuotave, të paktën 2%, ose të shumtën 6%, nga numri i përgjithshëm i të punësuarëve në çdo firmë që ka mbi 35 të punësuar, duhet të jenë persona me hendikep.”

Përveç dokumentit dhe kuadrit në të cilin janë definuar politikat e punësimit është Strategjia Nacionale për punësim 2015, në të cilën, për fat të keq, midis qëllimeve të definuara prioritare nuk është e përfshirë në mënyrë të theksuar zmadhimi i normës së punësimit të personave me pengesë. Kjo vetëm e tregon edhe një herë mungesën e qasjes strategjike ndaj këtij grupi të personave.⁷⁰

Edhe përkrah legjisllacionit të vazhdueshëm dhe politikave nacionale, numri i personave të punësuar me pengesë përballë të gjithë popullatës së punësuar në Republikën e Maqedonisë është mjaft i vogël. Domethënë sipas të dhënave nga Enti shtetëror për statistikë, në vitin 2011 numri i të punësuarëve me pengesë ishte 2.394 nga të cilët 814 ishin gra, dhe në mënyrë plotësuese, numri i personave me pengesë që kanë qënë në rehabilitim është 147 prej të cilëve 42 kanë qënë gra.⁷¹ Sipas të dhënave të fituara nga Agjencia për punësim, në vitin 2010 personat e papunësuar me pengesë mendore dhe trupore janë të shpërndarë në të gjitha grupmoshat (nga 15 deri 60 vjet dhe më shumë) dhe të cilët në numër të madh janë me kualifikim të ulët, domethënë 1.569 persona, dhe me arsim të lartë janë vetëm 35.

Siç shpjeguam edhe më lart, personat me pengesë mendore të ndjekur nga personat me pengesë fizike janë më shumë të diskriminuar gjatë punësimit për shkak të ekzistimit të një numri të madh

⁶⁹ Propozim - Ligj për punësimin e personave me invaliditet, MTSP, tetor viti 2014. Sipas propozim - nenit 40, Ligji planifikohet të zbatohet nga 1 janari i vitit 2015, derisa dispozitat e lidhura me sistemin e kuotave dhe rehabilitimi profesional i personave me pengesë do të fillojnë me zbatim nga 1 janari i vitit 2016.

⁷⁰ Shiko: Zhaneta Poposka, Bekim Kadriu, Lençe Kocavska, Elena Koçoska, *Analiza e praktikave diskriminuese në fushën e punësimit dhe marrëdhëniet e punës*, OBSE dhe MPPS, Shkup, viti 2013, faq.72.

⁷¹ Enti shtetëror për statistikë, Numër. 2.4.11.16, viti 2011, faq. 28-29.

të paragjytimeve ndaj këtyre personave. Kjo vërtetohet edhe me hulumtime të tjera që tregojnë se personat me pengesë nuk janë të pranuar si të punësuar në bazë të barabartë me të tjerët, që manifestohet nëpërmjet fitimit të rrogës më të vogël për të njëjtën punë, shanse më të vogla për përparim dhe shqetësim në vendin e punës.⁷² Gjithsej 25,9% e personave të anketuar me pengesë fizike konsiderojnë se kanë qënë të diskriminuar në vendin e punës, me atë që kanë konsideruar se më shpesh të diskriminuar janë personat që përkasin në grup moshën nga 35 deri 49 vjet. Ajo që është interesante për këtë hulumtim është ajo që e problematizon edhe diskriminimin e shumëfishtë, dhe ajo të grave me pengesë fizike dhe personat më të vjetër (me moshë mbi 50-vjeçare) me pengesë fizike.⁷³ Nga hulumtimet që janë kryer, veçanërisht për personat me pengesë fizike është treguar se 55,8% nga numri i përgjithshëm i personave të punësuar me pengesë fizike të gjithë janë të punësuar në shoqëri mbrojtëse, dhe ajo, numri më i madh prej tyre në ato që merren me dhënie të shërbimeve (40%). Hulumtimi ka treguar se gratë me pengesë trupore më shpesh punësohen në shoqëritë mbrojtëse (49,1%) dhe pastaj në tregun e hapur të punës (27,8%), derisa burrat me pengesë trupore më shumë punësohen në tregun e hapur të punës (33,3%) dhe pastaj në shoqëritë për mbrojtje (30%). Punësimi në sektorin publik është shumë i vogël dhe është 2,6%.⁷⁴

Rekomandime:

- Të ndryshohet dhe të përshtatet Ligji mbi marrëdhëniet e punës me standardet ndërkombëtare nëpërmjet parashikimit të instruksionit për diskriminim, parandalim në mënyrë të shprehur të njoftimeve ose deklaratave diskriminuese mbi bazë të pengesës, si edhe vendosjes së dispozitës që do të parashikojë përshtatje të arsyeshme për personat me pengesë.
- Të bëhet veçim i gjendjes shëndetësore dhe aftësisë për gjendjen e punës dhe aftësinë tek personat me pengesë, dhe të njëjtat të barazohen.
- Rishqyrtim të kriterit të gjendjes së përgjithshme shëndetësore, që e kufizon qasjen e personave me pengesë në vendet e punës në administratën shtetërore, gjyqësinë dhe avokaturën, dhe individualizim të plotë të saj në pajtueshmëri me nenin 25 nga Ligji mbi marrëdhëniet e punës, pra vënie të këtij kushti në kontekst të vetë profesionit.
- Në pajtueshmëri me Ligjin për punësim të personave invalidë, është e nevojshme që shteti ta garantojë sigurimin e mjeteve për Fondin e Veçantë, që do të përdoren në mënyrë të papenguar për sigurim të përshtatjes së arsyeshme për personat me pengesë në vendin e punës.
- Të ndryshohet dispozita në nenin 4-a paragrafi 5 nga Ligji për punësim të personave invalidë që parashikon se person invalid mund të jetë punëdhënës ose të kryejë punë të personit përgjegjës tek punëdhënësi vetëm nëse fiton mendim pozitiv nga Komisioni pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale, sepse është diskriminuese.
- Të ndërmerren masa që punësimi në shoqëritë mbrojtëse të jetë zgjidhje e përkohshme ndaj punësimit të plotë në tregun e hapur të punës së personave me pengesë.
- Të ndërtohet qasje strategjike ndaj personave me pengesë veçanërisht në Strategjinë nacionale për punësim në të cilën për fat të keq, midis qëllimeve të definuara prioritare nuk është e përfshirë në mënyrë të qartë zmadhimi i normës së punësimit të personave me pengesë.

⁷² Shiko: *Punësim të personave me invaliditet në kushte të tranzicionit*, NVO Ergos, Shkup, viti 2003, <<http://www.nvoinfocentar.org.mk/event.asp?site=nvo&menu=3&lang=mak&id=92>> E qasur në: 30.10.2014.

⁷³ Shiko: Vesna Jovanova, Sunçica Dimitrijoska, Stevan Tomovski, dhe Miodrag Ignjatović, *Pozicioni i personave me invaliditet trupor në tregun e punës, studim nga hulumtim*, me mbështetje të UNIFEM, Shkup, dhjetor viti 2009.

⁷⁴ Shiko: Vesna Jovanova, Sunçica Dimitrijoska, Stevan Tomovski, dhe Miodrag Ignjatović, *Pozicioni i personave me invaliditet trupor në tregun e punës, studim nga hulumtim*, me mbështetje të UNIFEM, Shkup, dhjetor viti 2009.

VI. STANDARDI PËRKATËS JETËSOR DHE MBROJTJA SOCIALE

Kushtetuta e definon Republikën e Maqedonisë si shtet social, që është i ndërtuar mbi bazë të humanizmit, të drejtës sociale dhe solidaritetit. Në nenin 35 është përmendur: “[R]epublika kujdeset për mbrojtjen sociale dhe sigurinë sociale të qytetarëve në pajtueshmëri me parimin e drejtësisë sociale”. Në mënyrë plotësuese, Republika e garanton të drejtën për ndihmë për qytetarët e pafuqishëm dhe të paaftë për punë dhe siguron mbrojtje të veçantë të personave invalidë dhe kushte për përfshirjen e tyre në jetën sociale (neni 35 paragrafi 3). Me këtë nen shteti i ndan njerëzit me pengesë (të quajtur persona me invaliditet) si grup i veçantë qytetarësh të cilëve u është e domosdoshme mbrojtje e veçantë. Ky nen le të kuptohet se duke pasur parasysh specificitetin e personave me pengesë janë të domosdoshme masa të veçanta, pra aksione afirmuese për realizimin e barazisë formale, që është kategori e garantuar me kushtetutë.

VI.1. Mbrojtja sociale

M. A merrni mobilitet, kompensim për mobilitet ato 7.000 denarë?

I: Jo, jo, po pres tashmë një vit dhe nuk mund të më bindë askush se nuk ka komision. Nuk mund të mos ketë komision. Mendoj se sjellja e tillë nuk është e drejtë dhe padrejtësi.

Burrë, 46 vjet, pengesë trupore

I. Unë kur aplikoj për kujdes të huaj thonë që kujdesin e huaj e japim për shoqërues them më gjeni një njeri që i cili për 4.000 den. do të vijë në orën 05. Sepse në 05.10 kam autobus dhe që do të më çojë në punë dhe do të vijë të më marrë në orën 03 (orën 15) për këto para. OK e jap kujdesin e huaj. Domethënë çmimi është qesharak.... shteti dëshiron të na dnihmojë. Ai dëshiron por nuk është e mjaftueshme.

Burrë, 54 vjet, person me shikim të dëmtuar

I. Unë kam kaç vjet, nuk jam shëruar - tani do të shërohem .. ashtu? Dhe tani çdo vit unë duhet të çoj dokumenta, të mbledh, nëse marr pension, nëse kam patur pronë .. kush do të më lerë pronë ? Nëse kam pronë, vetëm të kem, do ta shesh dhe do të kem para. Nuk më duhen 3.000 të më japësh ti .. ashtu?

Grua 55 vjet, pengesë trupore

I. Unë pa prindërit nuk mund të lëviz vetëm, nëse ata më çojnë jashtë unë do të jem jashtë nëse jo, jo. Unë jam i detyruar të rri në shtëpi, mbështetja psikologjike është shumë e rëndësishme sepse janë pak ata që bashkëpunojnë me ju, dhe ne atë e fitojmë vetëm nga prindërit. Del ajo që ne të gjithë jetën varemi nga prindërit.

Burrë, 40 vjet, pengesë trupore

I: Ja, për shembull, prindërit e mi asnjëherë nuk janë ankuar se duhet të më çojnë diku. Megjithatë, ndonjëherë e ndjej se nëna ime është shumë e lodhur, dhe unë e kam lënë se duhet të dal diku në darkë. Ajo nuk do të më thotë asnjë gjë, ajo do të më çojë por unë ndjehem keq, sepse e keqtrajtoj, e keqtrajtoj ... ajo nuk e ka problem të më çojë ... megjithatë, e ndjej kur është e lodhur, më vjen keq që e keqtrajtoj pikërisht, por ajo është e vetmja mënyrë për fat të keq që të arrij deri në vendin ku dëshiroj të shkoj.

Grua, 20 vjet, person me shikim të dëmtuar

I: Apartamenti është i imi, dhuratë nga babai. Nuk mundesha të konkurroj për anulimin e borxheve sepse kam borxhe në bankë. Nuk mundesha të konkurroj sepse jetoj me prindërit e mij. Kërkojen fitimet e përgjithshme familjare. Unë dhe bashkëshortja ime, nëna dhe babi im janë familja ime ... ne jemi familje. Por sepse e tejkalojmë limitin mbi 10.000 nuk mundeshim t'i anulojmë borxhet. Nuk mundesha të konkurroj dhe as që të mendoj të konkurroj.

Burrë, 46 vjet, pengesë trupore

Mbrojtja sociale është e përbërë nga shërbime dhe perfitime nga sistemi i financuar tatimor për mbrojtje sociale, dhe ajo: parandalimi social (që sipas ligjit për mbrojtje sociale përfshin punë edukativo - këshilluese, zhvillim të formave për ndihmë vetjake, punë vullnetare etj.), mbrojtje institucionale, mbrojtje jashtë - institucionale dhe ndihmë monetare, si edhe nga sistemi për sigurim social i themeluar në kontribute (sigurimi pensional dhe invalidor, sigurimi shëndetësor dhe sigurimi në rast të papunësisë). Ligji për mbrojtje sociale⁷⁵ nën person invalid nënkupton “[p]erson me pengesë mendore ose trupore” (neni 17). Ligji parashikon klauzolë të përgjithshme anti-diskriminuese, por për fat të keq pengesa nuk është e përfshirë si bazë e veçantë diskriminuese, që paraqet mangësi të madhe, duke pasur parasysh se numër i madh i të drejtave dhe përfitimeve dalin pikërisht nga ky ligj.

Të drejtë për ndihmë sociale (neni 45), mund të realizojë person që është i aftë për punë dhe i pa siguruar familiarisht dhe materialisht, që nuk posedon pronë dhe të drejta pronësie dhe realizon të ardhura më të ulta se shumica e ndihmës sociale. Lartësia e ndihmës monetare sociale për bartësin e të drejtës është 2.334 denarë (neni 47). Gjatë realizimit të kësaj të drejte merren parasysh të ardhurat mesatare mujore të të gjithë anëtarëve të bashkësisë (neni 46). Të drejtë për ndihmë të vazhdueshme monetare ka person i paftë për punë dhe i pasiguar materialisht, që nuk mund të sigurojë mjete për egzistencën e tij mbi bazë të dispozitave të tjera. Paftësia për punë për personat me pengesë me moshë mbi 26-vjet (paragrafi 2) është e vërtetuar me gjetje, vlerësim dhe mendim nga ana e komisionit profesional. Përkrah paftësisë për punë indikator i rëndësishëm është edhe statusi material, ku kërkuesi, pra anëtarët e familjes së tij nuk duhet të kenë të ardhura mujore më të mëdha se 5.000 denarë për person (neni 57). Kompensim monetar për ndihmë dhe kujdes nga person tjetër në pajtueshmëri me nenin 72 paragrafi 1, ka: “[p]erson me moshë mbi 26-vjeçare, me pengesa të moderuara, të rënda dhe të thella në zhvillimin mendor, person me pengesa të vështira dhe më të thella trupore, person plotësisht i verbër, si edhe person me ndryshime të përhershme në gjendjen shëndetësore, të cilit i është e domosdoshme ndihmë dhe kujdes nga person tjetër për shkak të asaj që nuk mund t'i plotësojë nevojat themelore jetësore, përderisa kjo e drejtë nuk mund të realizohet mbi bazë të dispozitave të tjera”.

Në pajtueshmëri me nenin 84-a paragrafi 1, me ligjin sigurohet shtesa për verbëri dhe mobilitet për: “[p]ersonin plotësisht të verbër, për person me invaliditet trupor prej 100% që përdor në mënyrë të pavarur karrige me rrota për invalidë ose person me kuadriplegji ose me pengesa të moderuara, të rënda dhe të thella në zhvillimin mendor që përdor karrige me rrotë, me moshë mbi 26 vjet”. Shuma mujore e shtesës është 7.000 denarë, vetëm nëse të ardhurat vjetore neto për personin mbi të gjitha bazat është të shumtën deri në shumën e përgjithshme vjetore të rrogave mesatare neto të paguara për çdo muaj për vitin paraprak (neni 84-2 paragrafi 9). Nga ana tjetër, shtesa për shurdhim (neni 84-b paragrafi 1), sigurohet për: “[p]erson totalisht të shurdhër me moshë mbi 26 vjet që ka perceptim të dëgjimit plotësisht të prekur dhe i njëjti nuk mund t'i plotësojë nevojat e tij jetësore pa interpretues në gjuhën e shenjave”. Shuma e shtesës për shurdhim është 4.000 denarë (neni 84-b paragrafi 5), dhe i njëjti mund të sigurohet vetëm nëse të ardhurat vjetore neto mbi të gjitha bazat e personit është të shumtën sa shumica e përgjithshme vjetore e rrogave mesatare neto mujore të paguara çdo muaj për vitin paraprak (neni 84-b paragrafi 4).

Mjetet nga të gjitha format e fitimeve monetare nga fusha e mbrojtjes sociale nuk janë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave themelore egzistenciale të personave që i përdorin këto lloje të mbrojtjes. Për këtë shkak, përdoruesit e përfitimeve monetare, edhe përkrah asaj që janë

⁷⁵Ligji për mbrojtje sociale, G.Z nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, [Teksti i konsoliduar: 148/13], 164/13, 187/13, 44/14, 116/14.

të mbrojtur me të drejtat nga fusha e mbrojtjes sociale gjenden ende nën rrezik social. Në mënyrë plotësuese, gjendja e përdoruesëve është e vështirësuar për shkak të sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm, dhe fitim të mendimit nga i njëjti profil i specialistëve të grupuar në komisione në ndryshme për realizim të përfitimit të ndryshëm për të cilat çdo përdorues duhet të paguajë, në pajtueshmëri me ligjin.⁷⁶

Pozicioni i pafavorshëm i personave me pengesë me kufirin e moshës dhe mundësia që t'i përdorin përfitimet sociale para dhe pas moshës prej 26 vjet ishte objekt edhe i dy iniciativave tek Gjykata kushtetuese të dorëzuara nga ana e Rrjetës për mbrojtje nga diskriminimi⁷⁷, ku u kërkua nga Gjykata kushtetuese që të përcaktohet se shtesa për mobilitet duhe të jetë për të gjithë personat me pengesë trupore 100% pa dallim nëse janë nën ose mbi moshën 26 - vjeçare dhe pa dallim nëse shërbehen me karrige me rrota ose nuk e përdorin aspak atë. Me vendim nga 25 statori i vitit 2013, Gjykata kushtetuese vërtetoi se nuk ngrihet procedurë për vlerësim të kushtetueshmërisë për dispozitën ligjore të kontestuar, derisa mbi bazë të iniciativës së dytë Gjykata vlerësoi se është në kuadër të autorizimit institucional të ligjvënësit për ta përcaktuar nivelin e sigurisë sociale të qytetarëve.

Të drejta për ndihmë monetare nga mbrojtja sociale janë parashikuar edhe për familjet biologjike dhe kujdestarët e personave me pengesë. Karakteristike edhe për këtë lloj ndihme monetare është ajo që familjet biologjike janë të vendosura në pozicion plotësisht të pafavorshëm⁷⁸. Domethënë kujdestari, përkrah kompensimeve për kujdesje të fëmijëve / personave me pengesë kanë të drejtë për ndihmë monetare në lartësi prej 8.000 (neni 71-a paragrafi 3) dhe të drejtë për pension, ndërsa familjet biologjike nuk mund të realizojnë asnjë lloj mbështetjeje nga ana e shtetit. Dhe e gjithë kjo çon në ngadalësim të procesit të deinstitutionalizimit, pra mjetet e pamjaftueshme të familjeve biologjike për egzistencë dhe i nxit t'i vendosin personat me pengesë në institucione.⁷⁹

Në ligjin për mbrojtje të fëmijëve⁸⁰ janë parashikuar përfitime monetare për fëmijët me pengesë, deri në moshë 26 vjeçare. Domethënë, të drejtat për mbrojtje sociale përfshijnë: 1) shtesë për fëmijë; 2) shtesë të veçantë; 3) ndihmë të vetme monetare për fëmijë të lindur; 4) pjesëmarrje; dhe 5) shtesë për prindërit për fëmijë të dytë, të tretë dhe të katërt. Shtesa e veçantë për fëmijë (SHVP) është "[k]ompensim monetar mujor për fëmijë me nevoja specifike që ka pengesa në zhvillimin trupor ose mendor deri në 26 vjet" (neni 24). Lartësia e shtesës së veçantë është 4,346 denarë për një fëmijë (neni 27). Me këtë kufi të vendosur për fëmijë me pengesë në këtë ligj, kufizohet e drejta e personave me pengesë që t'i përdorin përfitimet monetare të parashikuara me ligjin për mbrojtje sociale, që janë të parashikuara me pengesë në moshë mbi 26 vjeçare.

Mbrojtje jashtë-institucionale që realizohet në ose nëpërmjet qendrës për punë sociale përfshin të drejtë të: shërbimit të parë social të përdoruesëve të mbrojtjes sociale, ndihmë të individit, ndihmë të familjes, kujdes shtëpiak dhe ndihmë për individ dhe familje, pranim ditor dhe të përkohshëm dhe kujdesje si ndihmë të individit dhe familjes, akomodim në familje për kujdes, akomodim në shtëpi të vogël grupe dhe jetesë të organizuar me mbështetje.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat kanë edhe kompetenca në fushën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve (kopshte për fëmijë) dhe shtëpi për persona të moshuar dhe kompetenca të tjera në sferën sociale. Ky proces është i indikuar vetëm me transmetimin e obligimeve nga niveli qendror në nivelin lokal në domainin e mbrojtjes së personave të moshuar dhe mbrojtje për fëmijë. Në fushat e tjera që komunave u është dhënë mundësi për ofrim të shërbimeve sociale, në pajtueshmëri me planet dhe programet e tyre. Por në praktikë, shumica e komunave, përkrah kapaciteteve financiare, nuk kanë as kapacitete administrative që të përballen

⁷⁶ Shiko: Elena Koçoska, Zvonko Shavreski, *Projekt hulumtues: Çmimi i koston, Polio plus*, viti 2011, faq.35.

⁷⁷ Raport për rrjetën për mbrojtje nga diskriminimi, viti 2013, faq.37-39 <http://www.soros.org.mk/CMS/Files/Documents/izvestaj-mreza_za_zastita_od_diskriminacija1.pdf> E qasur në 01.11.2014.

⁷⁸ Shiko: *Hendikep – copëza e figurës që mungon, Tregim të gjendjes së pesonave me hendikep, Polio plus*, viti 2012

⁷⁹ Shiko: Violeta Vllahoviq, Anita Vojnovska Naumovska, Elena Grozdanova, Atula Kasumi, Tanja Kikerekova, Biljana Sajkovska, Zorica Stamenkovska, Vladimir Stojanoviq, Jovana Treņevska, Ipek Useinova, Nermina Fakoviq, Svetlana Cvetkovska, *Udhëheqës për zbatim të strategjisë nacionale për barazi dhe mosdiskriminim mbi bazë të përkatësisë etnike, moshës, pengesës mendore dhe trupore dhe mbi bazë të bazës gjinore*, Këshilli Britanik në Maqedoni, viti 2013, faq.50, <http://www.britishcouncil.mk/sites/britishcouncil.mk/files/vodic_nsen_mk.pdf> E qasur në: 21.10.2014.

⁸⁰ Ligji për mbrojtje të fëmijëve, G.Z nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14.

me këtë sfidë dhe paralelisht në këto komuna, ku ekzistojnë qendra ditore, ende nuk e kanë ndërmarrë kompetencën mbi to, për shkak të mosekzistimit të dispozitave obliguese në ligj⁸¹.

Ligje plotësuese që gjithashtu parashikojnë të drejta të caktuara nga mbrojtja dhe siguria sociale, dhe sillen për personat me pengesë janë Ligji për invalidët civilë nga lufta dhe Ligji për të drejtat e posaçme të anëtarëve të forcave të sigurisë së R.M dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Nëpërmjet këtyre ligjeve sigurohen përfitime të ndryshme për personat me pengesë, por jo sipas bazës së vetë pengesës, por për shkak të fitimit të pengesës⁸². Përkrah këtyre masave gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet dhe sigurimi pensional dhe invalidor, ku invaliditeti mund të lindë si pasojë e sëmundjes, lëndimit jashtë nga puna, lëndim gjatë punës ose sëmundje profesionale. Mbi bazë të definimit të vendosur të tillë për lindje të invaliditetit dalin edhe të drejtat për realizimin e pensionit invalidor.

Tekst numër 12, Kanal 77, 17.12.2014

NJË VARG AKTIVITETESH PËR INKLUZION TË PERSONAVE ME NEVOJA TË POSAÇME

“Edhe mësuesit dhe prindërit me fëmijë me nevoja të posaçme me paratë e tyre blejnë materiale dhe vegla për edukim, sepse Qendra ditore për fëmijë me nevoja të veçanta që funksionon në kuadër të një prej kopshteve të Shtipit, shpesh nuk disponojnë me to në sasi të mjaftueshme.”

VI.2. Strehim

Dispozitat më të rëndësishme në sferën e strehimit janë Ligji për strehim⁸³, Ligji për ndërtim⁸⁴, Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik⁸⁵, Ligji për menaxhim me hapësirën e banimit dhe hapësirën afariste⁸⁶, Ligji për vetëqeverisja lokale⁸⁷. Dispozitat e përmendura operacionalizohen nëpërmjet Programit të veçantë për grupe të prekshme (midis të cilave përkasin edhe personat me pengesë) të përgatitur nga ana e Ministrisë për transport dhe lidhjeve. Me Projektin për strehim të grupeve të prekshme sociale - F/P 1674 (2009) është parashikuar të ndërtohen dhe të shpërndahen gjithsej 1.754 apartamente në 32 ndërtesa banimi në 26 qytete në territorin e vendit.

Me Ligjin për mbrojtje sociale është rregulluar edhe e drejta e ndihmës monetare për strehim social (neni 83). Mënyra e realizimit të kësaj të drejte për personat përdorues të ndihmës së vazhdueshme monetare me akt i përcakton këshilli i komunës, të qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit (neni 83 paragrafi 3), dhe për personat që deri në moshë 18 vjeçare kanë patur status të fëmijës pa prindër dhe pa kujdes prindëror, dhe më së shumti deri në moshë 26- vjeçare, me akt të përgjithshëm i përcakton ministri. Në sistemin ekzistues nuk janë parashikuar masa plotësuese që do ta mundësojnë në mënyrë më efikase dhe më efektive procesin e strehimit për personat me pengesë. Në të njëjtën kohë, kësaj çështjeje i është lidhur edhe sigurimi i standardeve për qasje të papenguar si edhe zbatimi i tyre gjatë ndërtimit të shtëpive në pajtueshmëri me nevojat e qytetarëve me pengesë, si edhe sigurim të trajnimit të vazhdueshëm për stadnardet për qasje dhe disiponueshmëri dhe dizajnin universal.

Përkrah asaj, politikat për strehim duhet të definohen plotësisht në nivel kombëtar me qëllim që të sigurohen jo vetëm shtëpi, por edhe kushte adekuate banimi si parakusht për përfshirjen sociale.

⁸¹ Shiko: *Mekanizma për sigurim zë shërbimeve sociale në Maqedoni*, Ministra e punës dhe politikës sociale GIZ, viti 2011, faq.24, <http://www.nacionalnakomisija.gov.mk/sites/default/files/prikachyvanja/studija_mehanizmi_za_obezbeduvanje_na_socijalni_uslugi_vo_makedonija.pdf> E qasur në: 20.11.2014

⁸² Shiko: *Hendikep – pjesëza e figurës që mungon, Tregim i gjendjes së personave me hendikep*, Polio plus, viti 2012.

⁸³ Ligji për strehim, G.Z. nr. 99/09, 57/10, 36/11, 54/11, 13/12, 55/13, 163/13.

⁸⁴ Ligji për ndërtim, G.Z. nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13.

⁸⁵ Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik, G.Z. nr. 51/05, 137/07, 151/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11, 144/12, 55/13, 163/13.

⁸⁶ Ligji për menaxhim me hapësirën e banimit dhe hapësirën afariste, G.Z. nr. 2/94.

⁸⁷ Ligji për vetëqeverisje lokale, G.Z. nr. 5/02.

Tekst numër 13, Dnevnik, 20.11.2014

E SHPËRNGULUR ME DETYRIM PËR SHKAK TË LIGJIT PËR STREHIM

“Për shkak të energjisë elektrike të shkyçur në hyrjen e ndërtesës, ashensorët nuk punojnë, dhe person me pengesë që jeton në katin e tetë në ndërtesë nuk mund të zbresë. Edhe më shumë, ndaj reagimit të personit me pengesë banuesit përgjigjen se është më mirë të shpërngulet tek të afërmit derisa të tjerët nuk i paguajnë faturat”.

VI.2.1. Deinstitutionalizimi

Të drejtën e strehimit në familje kujdestare në pajtueshmëri me nenin 32, sigurohet për: [p]ersonat me pengesa të moderuara dhe të vështira në zhvillimin mendor, person me pengesa të thella në zhvillimin mendor dhe persona me pengesë të përhershme trupore të cilët i është e nevojshëm kujdes i përhershëm, person i rritur me pengesë trupore dhe person me pengesa në zhvillimin mendor, që nuk është në gjendje të kujdeset vetëm, dhe për shkak të pozicionit banues dhe familjar nuk ka mundësi t'i sigurohet mbrojtje në mënyrë tjetër. Zgjedhjen e familjes kujdestare dhe llojin e strehimit, e bën Qendra për punë sociale (neni 33). Familja kujdestare fiton kompenzim mujor për shpenzimet për personin e strehuar në shumën prej 6.000 denarë për person me pengesë dhe kompensim për kujdes në lartësi prej 2.500 denarë për person me pengesë. Në mënyrë plotësuese, është parashikuar edhe sigurim pensional dhe invalidor dhe mbrojtje shëndetësore për kujdestarët (neni 37).

Të drejtë banimi në banesë të vogël grupore në pajtueshmëri me nenin 39, ka: [f]ëmijë me pengesa në zhvillimin mendor ose trupor, person me pengesë mendore ose trupore, që nuk ka kushte të përshtatshme për jetesë në familjen e tij, që nuk ka familje ose në mënyrë tjetër i është e nevojshëm strehim në banesë të vogël grupore”. Të drejtë për jetesë të organizuar me mbështetje, në pajtueshmëri me nenin 40, ka person me pengesë mendore ose trupore, jetesë të pavarur dhe të organizuar në njësi të veçantë banimi me ndihmë të përhershme ose të përkohshme nga persona profesionale ose persona të tjerë në realizimin e nevojave themelore për jetë, nevojave sociale, për punë, nevoja kulturore, rekreative dhe nevoja të tjera. Niveli i mbështetjes përcaktohet në pajtueshmëri me nevojat, llojin dhe nivelin e pengesës të përdoruesit (neni 40 paragrafi 2).

Përkrah mbrojtjes jashtë-institucionale, me Ligjin dhe mbrojtjen institucionale që përfshin midis të tjerave, edhe të drejtë për strehim në institucion për mbrojtje sociale (neni 43). Kjo e drejtë mund ta realizojë person që nuk ka kushte të përshtatshme për jetesë në familjen e tij ose për arsye të tjera i është e nevojshëm strehim në institucion për mbrojtje sociale, dhe nuk mund të zbatohet formë tjetër e mbrojtjes sociale.

Sipas të dhënave të disponueshme deri në 1 janar të vitit 2011, 22.684 persona me pengesë fitojnë përfitime sociale dhe/ose ndihmë sociale, prej të cilëve 6568 janë fëmijë (3.296 me pengesë intelektuale dhe 3.272 me pengesë trupore), dhe 16.116 janë të rritur (18+)⁸⁸. Gjithnjë e më shumë persona me pengesë të moderuar dhe të rëndë intelektuale janë të kujdesur në qendrat për qëndrim ditore që janë të lokalizuara në komuna të ndryshme nëpër të gjithë vendin. Qendrat ditore sigurojnë strehim të përditshëm, kujdes, ushqim, rehabilitim psikosocial dhe riedukim, këshillim për persona me pengesë të moderuar dhe të vështirë (kryesisht fëmijë në moshë nga 5-18). Ekzistojnë 23 qendra ditore dhe ato janë kryesisht të lokalizuara në rajone urbane. Gjithashtu, Ministria merr pjesë në financimin e 4 qendrave ditore për persona të rritur me pengesë të moderuar dhe të rëndë mendore, e udhëhequr nga ana e OJQ Mesazh.

Në praktikë vetë procesi i deinstitutionalizimit përballet me numër të madh të problemeve. Një nga rekomendimet e Avokatit të popullit është që të vazhdohet procesi i deinstitutionalizimit me vendosje të periudhës së detyrueshme përgatitore për përdoruesin ku do të respektohet edhe mendimi i përdoruesit. Ky rekomandim vjen pas shqyrtimit se “një përdorues që me procesin e deinstitutionalizimit ka qënë i transferuar në qendër ditore jashtë nga Enti, por që nuk ka mundur të përshtatet me kushtet e reja. Për shkak të mos patjes së periudhës së mjaftueshme për

⁸⁸ Shiko: *Mbrojtje sociale e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve 2013-2014*, Enti shtetëror për statistikë, Publikimi numër 2.4.13.18 763, viti 2013.

përshtatje personi nuk ka pranuar të qendrojë në qendrën ditore, ku është kthyer dukshëm i shqetësuar⁸⁹.

Në të njëjtën kohë, kushtet joadekuate për strehim të personave me pengesë në institucionet rezidenciale është udhëzuar si mjaft shqetësuese. Pra, gjatë kontrollit nga ana e Avokatit të popullit në C.3, Banja Bansko ka qënë “[ë]shtë hasur fëmijë shurdhmemec që për shkak të pengesës së tij, ka qënë i lidhur me litar në krevat, dhe njëkohësisht në entin ishin strehuar dhe një fëmijë me rrezik social, një person me pengesë mendore, si edhe person me shqetësime psikike, por pa invaliditet trupor.”⁹⁰ Konstatimi është i ngjashëm edhe gjatë shqyrtimit në C.3. Demir Kapi⁹¹.

Për mbrojtjen institucionale, shteti ndan mjete më mëdha monetare, që megjithatë në realitet nuk mundësojnë jetë me dinjitet për personat me pengesë.⁹²

Hulumtimet tregojnë se, personat me pengesë janë më shumë të diskriminuar gjatë sigurimit të strehimit përkatës dhe përfshirjen e tyre në bashkësi, për shkak të ekzistimit të paragjytimeve të numërta ndaj këtyre personave. Pra, personat me pengesë intelektuale do tu pengonin si fqinjë 27% të popullatës së anketuar, personat me pengesë fizike janë më shumë të pranueshëm si fqinjë se ata me pengesë intelektuale⁹³. Në nivel lokal nuk ekziston infrastruktura përkatëse, dhe as mekanizëm i përshtatshëm për ndarje të mjeteve për mbrojtje sociale që nuk do të jetë e reduktuar vetëm në mbrojtje materiale, por edhe në aspekte të tjera në sferën e inkuadrimit social.⁹⁴ Në mënyrë plotësuese, edhe përkrah asaj që institucionet rezidenciale⁹⁵ janë formë e domosdoshme për strehim, megjithatë në praktikë ka nevojë për forma të reja të shërbimeve⁹⁶, si edhe tejkalim të sistemit të vjetërsuar të vlerësimit të nevojave “specifike” të personave me pengesë.

Tekst numër 14, Dnevnik, 20.11.2014

PERSONAT ME PENGESË DHE FAMILJET E TYRE TË MARGJINALIZUARA

“Familjet që do të kujdesen për person me pengesë fitojnë para nga shteti dhe fitojnë të drejtë pensioni, por familjet biologjike nuk fitojnë asgjë, ankohen prindërit e fëmijëve me pengesë.”

VI.3. Standardi përkatës jetësor

Përkrah masave për mbrojtje sociale, nga ana e shtetit ndërmerren edhe masa plotësuese me qëllim parandalimin dhe tejkalimin e rreziqeve themelore sociale. Nën rrezik social nënkuptohen: rreziqe për shëndetin (sëmundje, lëndim dhe invaliditet); rreziqe të pleqërisë dhe plakjes; rreziqe të fëmijës njëprindërore; rreziqe nga papunësia, humbje të të ardhurave për mirëmbajtje mbi bazë të punës dhe në mënyrë të ngjashme; rreziqe nga varfëria dhe rreziqe nga lloj tjetër i përjashtimit social.

Këtu duhet të përmenden dy dokumenta të rëndësishëm: Strategjia kombëtare për zvogëlim të varfërisë dhe përjashtimit social 2010-2020 dhe Programi kombëtar për zhvillim të mbrojtjes

⁸⁹ Raport vjetor i Avokatit të popullit 2013, faq.73.

⁹⁰ Raport vjetor i Avokatit të popullit 2013, faq.35-36.

⁹¹ Raport vjetor i Avokatit të popullit 2013, faq.59.

⁹² Shiko: Zvonko Shavreski, Elena Koçoska, *Libër i bardhë - Institucionalizimi - realiteti ynë*, viti 2009, faq.30.

⁹³ Shiko: Violeta Vllahoviq, Anita Vojnovska Naumovska, Elena Grozdanova, Atulla Kasumi, Tanja Kikerekova, Biljana Sajkovska, Zorica Stamenkovska, Vladimir Stojanoviq, Jovana Trencëvska, Ipek Useinova, Nermina Fakoviq, Svetlana Cvetkovska, *Udhëheqës për zbatimin e strategjisë kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim mbi bazë të përkatësisë etnike, moshës, pengesës mendore dhe trupore dhe mbi bazë gjinore*, Këshilli Britanik në Maqedoni, viti 2013, faq.25, <http://www.britishcouncil.mk/sites/britishcouncil.mk/files/vodic_nsen_mk.pdf> E qasur në: 21.10.2014.

⁹⁴ Shiko: *Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë - gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal*, MTSP, viti 2012, faq.39.

⁹⁵ Shiko: *Raport nga hulumtimi për gjendjet në marrëdhënie të implementimit të Konventës së KB për të drejtat e personave me pengesë*, Mesazh, viti 2012, faq.20.

⁹⁶ Shiko *Studim për varfërinë dhe përjashtimin social në Republikën e Maqedonisë, Probleme dhe nevoja lokale sociale*, MTSP, viti 2011, faq.213 dhe faq.221.

sociale 2010-2020, në të cilën janë inkorporuar edhe masa për përparimin e gjendjes për personat me pengesë.

Programi, për kompensim të kushtëzuar monetar për arsim të mesëm, i marrë nga ana e Qeverisë, ka për qëllim, “përmirësimin e qasjes dhe kualitetit të arsimit për nxënës në arsimin e mesëm për familjet që janë përdorues të së drejtës për ndihmë sociale monetare”.

